



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.46

23 prill

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 096 datë 19.3.2009	Për ratifikimin e memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit European për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin “Europa për qytetarët”	2275
Ligj nr.10 097 datë 19.3.2009	Për një shtesë në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar	2279
Ligj nr.10 098 datë 19.3.2009	Për një ndryshim në ligjin nr.9981, datë 8.9.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar	2279
Ligj nr.10 105 datë 30.3.2009	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së themelimit të Korporatës Islamike për zhvillimin e sektorit privat”	2280
Ligj nr.10 106 datë 30.3.2009	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave”	2298
Ligj nr.10 107 datë 30.3.2009	Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë	2304
Ligj nr.10 110 datë 2.4.2009	Për një ndryshim dhe një shtesë në ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar	2314
Ligj nr.10 111 datë 2.4.2009	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9831, datë 12.11.2007 “Për dëshmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”	2314
	Ndreqje gabimi	2318

LIGJ
Nr.10 096, datë 19.3.2009

PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT TË MIRËKUPITIMIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KOMUNITETIT EUROPIAN PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN “EUROPA PËR QYTETARËT”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit European për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programin “Europa për qytetarët”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekreten nr.6123, datë 8.4.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

MEMORANDUM MIRËKUPITIMI
NDËRMJET KOMUNITETIT EUROPIAN DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
MBI PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROGRAMIN “EUROPA PËR QYTETARËT”

Komisioni i Komuniteteve Europiane, në vijim referuar si “Komisioni”, në emër të Komunitetit European, nga njëra anë, dhe Republika e Shqipërisë, në vijim referuar si “Shqipëria”, nga ana tjetër,

Ndërsa:

1. Marrëveshja kuadër e datës 22 nëntor 2004 ndërmjet Komunitetit European dhe Republikës së Shqipërisë¹ vendos parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Shqipërisë në programet e Komunitetit, duke i lënë Komisionit dhe autoriteteve kompetente të Shqipërisë të përcaktojnë termat dhe kushtet e veçanta, duke përfshirë kontributin financiar, në lidhje me këtë pjesëmarrje në secilin program të veçantë;

2. Programi “Europa për qytetarët” u caktua me vendimin nr. 1904/2006/EC të Parlamentit European dhe Këshillit të datës 12 dhjetor 2006², kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Shqipëria do të marrë pjesë në programin “Europa për qytetarët” (në vijim referuar si “Programi”), në pajtim me kushtet e parashikuara në Marrëveshjen kuadër të datës 22 nëntor 2004 ndërmjet Komunitetit European dhe Republikës së Shqipërisë mbi parimet e përgjithshme për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në programet e Komunitetit, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në anekset I, II dhe III të këtij memorandumi mirëkuptimi.

Neni 2

Ky memorandum mirëkuptimi do të shtyhet për kohëzgjatjen e programit. Megjithatë, nëse

¹ FZ L 192, 22.7.2005, f.2.

² FZ L 378, 27.12.2006, f.32.

Komuniteti European vendos të shtyjë afatin pa ndonjë ndryshim thelbësor brenda programit, ky memorandum do të shtyhej përkatësisht dhe automatikisht nëse asnjë palë nuk e denoncon atë brenda një muaji pas vendimit të shtyrjes.

Aneksat I, II dhe III përbëjnë pjesë integrale të këtij memorandum mirëkuptimi.

Ky memorandum mirëkuptimi mund të ndryshohet vetëm me shkrim me pëlqimin e përbashkët të palëve.

Ky memorandum mirëkuptimi hyn në fuqi në datën e njoftimit me shkrim, nëpërmjet të cilit Shqipëria njofton Komisionin, nëpërmjet kanaleve diplomatike, që janë përmbushur kërkesat e saj të brendshme ligjore për hyrjen e tij në fuqi. Ai hyn në fuqi nga viti financiar 2009.

ANEKSI I

TERMAT DHE KUSHTET PËR PJESËMARRJEN E SHQIPËRISË NË PROGRAMIN “EUROPA PËR QYTETARËT”

1. Nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë memorandum mirëkuptimi, Shqipëria do të marrë pjesë në aktivitetet e programit “Europa për qytetarët” (në vijim referuar si “Programi”) në pajtim me objektivat, kriteret, procedurat dhe afatet e përcaktuara në vendimin nr.1904/2006/EC të Parlamentit European dhe të Këshillit të datës 12 dhjetor 2006 që cakton këtë program të Komunitetit.

2. Për të marrë pjesë në program, Shqipëria do të paguajë çdo vit një kontribut në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit European sipas modaliteteve të përshkruara në aneksin II. Nëse është e nevojshme, duke marrë parasysh zhvillimet e programit ose zhvillimin e kapacitetit përthithës të Shqipërisë, ky kontribut mund të përshtatet me shkrim, me pëlqimin e përbashkët të palëve, për të mënjeluar mospërputhjen buxhetore në zbatimin e programit.

3. Termat dhe kushtet për dorëzimin, vlerësimin dhe përzgjedhjen e kërkesave në lidhje me institucionet dhe organizatat e përshtatshme të Shqipërisë do të jenë të njëjta si ato që zbatohen për institucionet dhe organizatat e përshtatshme të Komunitetit.

4. Me qëllim sigurimin e dimensionit komunitar të programit, për të qenë i përshtatshëm për mbështetjen financiare të Komunitetit, kërkesat duhet të përfshijnë partnerë ose aktivitete në shtetet anëtare të Komunitetit sipas parashikimit në udhëzimin e programit ose ftesën për propozime.

5. Kërkuesit ose partnerët nga Shqipëria do të jenë të përshtatshëm për mbështetje komunitare me kusht që kërkesat përkatëse të jenë bërë pas hyrjes në fuqi të këtij memorandum mirëkuptimi.

6. Shuma maksimale e mbështetjes financiare për aktivitetet e strukturës së informacionit dhe komunikimit për këtë program në Shqipëri (të quajtur Europa për pikën e qytetarëve) nuk do të kalojë 50% të buxhetit të plotë për aktivitetet e tij, brenda një kufiri maksimal prej 10 000 eurosh.

7. Pa cenuar përgjegjësitë e Komisionit të Komuniteteve Europiane dhe të Gjykatës së Auditëve të Komuniteteve Europiane në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e programit, pjesëmarrja e Shqipërisë në program do të monitorohet vazhdimisht mbi një bazë partneriteti, duke përfshirë Komisionin e Komuniteteve Europiane dhe Shqipërinë. Shqipëria i paraqet Komisionit raporte përkatëse dhe merr pjesë në aktivitetet e tjera të veçanta të parashikuara nga Komuniteti në atë kontekst.

Rregullat në lidhje me kontrollin financiar, zhdëmtimin dhe masat e tjera kundër mashtrimit parashikohen në aneksin III.

8. Gjuha që do të përdoret në të gjitha llojet e kontakteve me Komisionin, në lidhje me procesin e dorëzimit të kërkesës, kontratat, raportet që duhet të paraqiten dhe masat e tjera administrative të programit do të bëhen në një nga gjuhët zyrtare të Komunitetit.

9. Komuniteti dhe Shqipëria mund të ndërpresin aktivitetet sipas këtij memorandum mirëkuptimi në çdo kohë pas një njoftimi me afat dymbëdhjetë muaj. Projektet dhe aktivitetet e papërfunduara në momentin e ndërprerjes do të vazhdojnë deri në përfundimin e tyre sipas kushteve të parashikuara në këtë memorandum mirëkuptimi, si dhe në masat kontraktuale që zbatohen për këto projekte dhe aktivitete dhe në dispozitat e aneksit III.

ANEKSI II

KONTRIBUTI FINANCIAR I SHQIPËRISË NË PROGRAMIN “EUROPA PËR QYTETARËT”

1. Kontributi financiar që duhet të paguhet nga Shqipëria në buxhetin e Bashkimit European për të marrë pjesë në programin “Europa për qytetarët” është 20 000 euro.

2. Shqipëria do të financojë kontributin e përmendur më sipër pjesërisht nga Buxheti i Shtetit të Shqipërisë dhe pjesërisht nga fondet e paraadërimit të Shqipërisë, duke iu nënshtruar procedurave vjetore të programimit brenda kuadrit të rregullores së Këshillit (EC) nr. 2666/2000 të datës 5 dhjetor 2000, të ndryshuar me rregulloren (EC) nr.2415 të datës 10 dhjetor 2001 mbi asistencën për Shqipërinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Kroacinë, Republikën Federale të Jugosllavisë dhe Ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe rregulloren e Këshillit (EC)1085/2006 të datës 17 korrik 2006. Fondet e kërkuara të paraadërimit do t'i transferohen Shqipërisë çdo vit, si një rimbursim për pjesën e kontributit financiar vjetor të paguar faktikisht në përgjigje të ftesave vjetore për fonde nga Komisioni.

3. Grafiku kohor provizor në lidhje me fondet e paraadërimit është si më poshtë:

Viti 2009 (fondet CARDS 2006)	Viti 2010 (fondet IPA 2008)	Viti 2011 (fondet IPA 2009)	Viti 2012 (fondet IPA 2010)	Viti 2013 (fondet IPA 2011)
15 000	14 000	13 000	12 000	11 000

Pjesa që mbetet nga kontributet e Shqipërisë do të mbulohen nga Buxheti i Shtetit i Shqipërisë.

Nëse këto shuma treguese nuk konfirmohen në procedurën vjetore të programimit të paraadërimit, Buxheti i Shtetit i Shqipërisë do të mbulojë diferencën ndërmjet kontributit të përgjithshëm financiar të treguar në pikën 1 më sipër dhe mbështetjes së paraadërimit të ofruar.

4. Rregullorja financiare e zbatueshme në buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit European do të zbatohet specifikisht për menaxhimin e kontributit të Shqipërisë.

Shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzimet e qëndrimit të bëra nga përfaqësuesit dhe ekspertët e Shqipërisë për qëllimet e pjesëmarrjes si vëzhgues në punën e komitetit të përmendur në nenin 9 të vendimit nr.1904/2006/EC të Parlamentit European dhe të Këshillit të datës 12 dhjetor 2006 ose mbledhjet e tjera në lidhje me zbatimin e programit do të rimbursohen nga Komisioni mbi të njëjtën bazë dhe në pajtim me procedurat tashmë në fuqi për përfaqësuesit dhe ekspertët e shteteve anëtare të Bashkimit European.

5. Pas hyrjes në fuqi të këtij memorandumi mirëkuptimi dhe në fillim të çdo viti pasues, Komisioni i dërgon Shqipërisë një ftesë për fonde që përputhet me kontributin e saj në buxhetin e programit sipas këtij memorandumi mirëkuptimi.

Ky kontribut shprehet në euro dhe paguhet në një llogari bankare të Komisionit në euro.

Shqipëria do të paguajë kontributin e saj afërsisht më 1 maj, me kusht që ftesa për fonde të dërgohet nga Komisioni para datës 1 prill, ose jo më vonë se një muaj pasi të jetë dërguar ftesa për fonde nëse kjo dërgohet më vonë.

Çdo vonesë në pagesën e kontributit shkakton pagesën e interesit nga Shqipëria për shumën e papaguar nga data e kërkueshme. Norma e interesit përputhet me normën e zbatuar nga Banka Europiane Qendrore për operacionet e refinancimit të principalit, siç publikohet në serinë C të Fletores Zyrtare të Bashkimit European në fuqi ditën e parë kalendarike të muajit në të cilën bie data e kërkueshme, e shtuar me 3.5 pikë përqindje.

ANEKSI III

KONTROLI FINANCIAR, ZHDËMTIMI DHE MASA TË TJERA KUNDËR MASHTRIMIT

I. Kontrollat dhe masat kundër mashtrimit nga Komuniteti

1. Në pajtim me rregulloren financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit European dhe me rregullat e tjera të përmendura në këtë Memorandum Mirëkuptimi, kontratat e lidhura me përfituesit e programeve të vendosur në Shqipëri parashikojnë kryerjen e auditimeve financiare ose të tjera që duhet të zhvillohen në çdo kohë në ambientet e përfituesve dhe të nënkontraktorëve të tyre nga agjentët e Komisionit ose nga persona të tjerë të mandatuar nga Komisioni.

2. Agjentët e Komisionit dhe persona të tjerë të mandatuar nga Komisioni hyjnë rregullisht në kantieri, objekte pune dhe dokumente dhe në të gjithë informacionin e kërkuar, me qëllim që të kryhen këto auditime, duke përfshirë formatin elektronik. Kjo e drejtë hyrjeje parashikohet shprehimisht në kontratat e lidhura për të zbatuar instrumentet e përmendura në këtë memorandum. Gjykata Europiane e Auditëve ka të njëjtat të drejta si Komisioni.

3. Brenda kuadrit të këtij memorandumi, Komisioni/OLAF (Zyra Europiane kundër Mashtrimit) autorizohet të kryejë kontrolle dhe inspekte në vend në territorin e Shqipërisë, në pajtim me dispozitat

procedurale të rregullores së Këshillit (EURATOM, EC) nr.2185/96, të datës 11 nëntor 1996.

Këto kontrolle dhe inspektime përgatiten dhe zhvillohen në bashkëpunim të ngushtë me autoritetet kompetente shqiptare të caktuara nga autoritetet shqiptare, që njoftohen në kohën e duhur për objektin, qëllimin dhe bazën ligjore të kontrolleve dhe inspektimeve, në mënyrë që ato të japin të gjithë ndihmën e kërkuar.

Nëse autoritet shqiptare të interesuara e kërkojnë, kontrollet dhe inspektimet në vend mund të zhvillohen së bashku me to.

Nëse pjesëmarrësit në programe e kundërshtojnë kontrollin ose inspektimin në vend, autoritetet shqiptare, duke vepruar në pajtim me rregullat e tyre të brendshme, u japin inspektorëve të Komisionit/OLAF-it ndihmën që atyre u duhet për të përmbushur detyrën e tyre për të kryer kontrollin ose inspektimin në vend.

Komisioni/OLAF-i raporton sa më shpejt të jetë e mundur tek autoritetet shqiptare çdo fakt ose dyshim në lidhje me një parregullsi është sjellë në vëmendje të tyre gjatë kontrollit ose inspektimit në vend. Në çdo rast, Komisionit/OLAF-it i kërkohet të informojë autoritetin e sipërpërmendur për rezultatin e këtyre kontrolleve dhe inspektimeve.

II. Informacioni dhe konsultimi

1. Për qëllimet e zbatimit të duhur të këtij aneksi, autoritetet kompetente shqiptare dhe të Komunitetit shkëmbejnë rregullisht informacione dhe, me kërkesë të njëres prej palëve, zhvillojnë konsultime.

2. Autoritetet kompetente shqiptare informojnë Komisionin pa vonesë për çdo fakt ose dyshim që silltet në vëmendje të tyre në lidhje me një parregullsi përsa i takon përfundimit dhe zbatimit të kontratave të lidhura duke zbatuar instrumentet e përmendura në këtë memorandum.

III. Masat administrative dhe gjobot

Pa cenuar zbatimin e ligjit penal shqiptar, masat administrative dhe gjobot mund të vendosen nga Komisioni në pajtim me rregulloren financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Bashkimit Europian.

IV. Zhdëmtimi

Vendimet e marra nga Komisioni brenda objektit të këtij memorandumit që vendosin një detyrim financiar mbi personat e ndryshëm nga shtetet janë të ekzekutueshme në Shqipëri. Ekzekutimi rregullohet nga rregullat e procedurës civile në fuqi në Shqipëri. Urdhri për ekzekutimin i bashkëngjitet vendimit, pa formalitet tjetër përveç verifikimit të autenticitetit të vendimit, nga autoriteti i brendshëm që Qeveria e Shqipërisë e cakton për këtë qëllim dhe ia bën të ditur Komisionit. Pasi të jenë përfunduar këto formalitete për kërkesën nga Komisioni, ky i fundit mund të vazhdojë me ekzekutimin në pajtim me ligjin e brendshëm, duke e sjellë çështjen drejtpërdrejt tek autoriteti kompetent. Ligjshmëria e vendimit të Komisionit i nënshtrohet kontrollit nga Gjykata e Drejtësisë e Komuniteteve Europiane.

Vendimet e dhëna nga Gjykata e Drejtësisë e Komuniteteve Europiane, në pajtim me një dispozitë arbitrazhi në një kontratë brenda objektit të këtij memorandumit, janë të ekzekutueshme në të njëjtat kushte.

V. Komunikimi i drejtpërdrejtë

Komisioni komunikon drejtpërdrejt me pjesëmarrësit në programin “Europa për qytetarët” të vendosur në Shqipëri dhe me nënkontraktorët e tyre. Ata mund t’i paraqesin drejtpërdrejt Komisionit të gjithë informacionin dhe dokumentacionin përkatës që atyre u kërkohet të paraqesin mbi bazën e instrumenteve të përmendura në këtë memorandum dhe të kontratave të lidhura për zbatimin e tyre.

LIGJ

Nr.10 097, datë 19.3.2009

PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8405, DATË 17.9.1998 “PËR URBANISTIKËN”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar, në fund të nenit 51 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, përpara marrjes së dokumentit të lejes së ndërtimit paguhet 0,1 për qind e vlerës së investimit, që depozitohet për llogari të financimit të studimeve urbanistike të pushtetit vendor, por, në çdo rast, jo më e vogël se vlera e nevojshme për të financuar studimet, që pushteti vendor duhet të bëjë për këto investime të infrastrukturës, përveçse kur është parashikuar ndryshe në ligje të veçanta.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6124, datë 8.4.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.10 098, datë 19.3.2009

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.9981, DATË 8.9.2008 “PËR MIRATIMIN E NIVELEVE TË
TARIFËS DOGANORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr.9981, datë 8.9.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Në lidhjen nr.1 “Nomenklatura e kombinuar e mallrave, 2008”, që i bashkëlidhet ligjit, tarifa doganore, që i përket kodit NK 27160000, përshkrimi “Energji elektrike” nga “2 për qind” bëhet “pa taksë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6125, datë 8.4.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.10 105, datë 30.3.2009

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË THEMELIMIT TË KORPORATËS ISLAMIKE
PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT PRIVAT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja për themelimin e Korporatës Islamike për Zhvillimin e Sektorit Privat”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6127, datë 8.4.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE THEMELUESE
KORPORATA ISLAMIKE PËR ZHVILLIMIN E SEKTORIT PRIVAT

Qeveritë dhe institucionet në emër të të cilave nënshkruhet kjo marrëveshje
duke pranuar që qëllimi i Bankës Islamike për Zhvillim është nxitja e zhvillimit ekonomik dhe e përparimit social me anë të inkurajimit të zgjerimit si të ndërmarrjeve produktive shtetërore, dhe ato private në vendet anëtare të Bankës Islamike për Zhvillim, në pajtim me parimet e Shari’ah-ut;
duke marrë në konsideratë prirjen në këto vende anëtare të transferimit të financimit të projekteve të zhvillimit nga sektori publik në atë privat, që çojnë në lindjen e mundësive të reja që sektori privat të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të vendeve anëtare;
duke kuptuar nevojën për nxitjen e zgjerimit të ndërmarrjeve private produktive në vendet anëtare;
të bindur për nevojën e krijimit të një institucioni ndërkombëtar të pavarur me qëllim që të trajtojë efektivisht sektorin privat në vendet anëtare;
me anë të kësaj Marrëveshjeje, bien dakord sa më poshtë:

KAPITULLI I
KIRJIMI, PERSONALITETI JURIDIK, QËLLIMI, FUNKSONET, KOMPETENCAT, POLITIKAT DHE
ANËTARËSIA

Neni 1

Krijimi

Korporata Islamike për Zhvillimin e Sektorit Privat (në vijim e referuar si Korporata) krijohet në bazë të kësaj Marrëveshjeje si një institucion ndërkombëtar i specializuar për të përmbushur qëllimin publik të parashikuar në paragrafin 1 të nenit 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Personaliteti juridik

Korporata zotëron personalitet të plotë juridik dhe, në veçanti, kapacitet të plotë:

- i) për të kontraktuar;
- ii) për të blerë dhe shitur prona;
- iii) për të filluar procedime ligjore para gjykatave të arbitrazhit dhe gjykatave.

Neni 3

Qëllimi

1. Qëllimi i Korporatës është të nxisë në pajtim me parimet e Shari’ah-ut zhvillimin ekonomik të vendeve të tij anëtare, duke inkurajuar krijimin, zgjerimin dhe modernizimin e ndërmarrjeve private që prodhojnë mallra dhe shërbime në mënyrë të tillë që të plotësojnë aktivitetet e Bankës Islamike për Zhvillim (në vijim e referuar si “Banka”).

2. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, ndërmarrjet në vendet anëtare me pjesëmarrje të pjesshme aksionesh nga qeveritë ose entet e tyre publike, që nuk tejkalojnë dyzet e nëntë për qind të fondit votues, që

operojnë mbi baza tregtare dhe aktivitetet e të cilave forcojnë sektorin privat, konsiderohen të jenë ndërmarrje private.

Neni 4 **Funksionet**

1. Për përmbushjen e qëllimit të saj, Korporata mund të marrë përsipër funksionet e mëposhtme në mbështetje të ndërmarrjeve të referuara në nenin 3:

a) asiston, vetëm ose në bashkëpunim me burimet e tjera të financimit, financimin e krijimit, zgjerimit dhe modernizimit të ndërmarrjeve private, duke përdorur instrumentet dhe mekanizmat financiarë të cilat Korporata i çmon të nevojshme në çdo instancë;

b) lehtëson aksesin e tyre në kapitalin privat dhe publik, vendas dhe të huaj, duke përfshirë aksesin në tregjet e kapitalit;

c) stimulon zhvillimin e mundësive për investim që favorizojnë qarkullimin e kapitalit privat, vendas dhe të huaj në investime në vendet anëtare;

d) kontribuon në zhvillimin dhe diversifikimin e produkteve financiare duke i kushtuar vëmendjen e duhur pajtueshmërisë me parimet e bazuara në administrimin e matur të burimeve të Korporatës; dhe

e) siguron asistencë teknike për përgatitjen, financimin dhe zbatimin e projekteve, duke përfshirë transferimin e teknologjisë së përshtatshme.

2. Korporata mund të ofrojë shërbime këshillimore për vendet anëtare dhe ndërmarrjet e tyre publike dhe private mbi çështje që lidhen me qëllimin e saj si kushtet e një mjedisi tërheqës për investim privat, identifikimin dhe nxitjen e mundësive të investimit, shndërrimin e stabilimenteve dhe shoqërive private të kufizuara me pronar të vetëm në shoqëri publike, privatizimin e ndërmarrjeve shtetërore, shkrirjen e ndërmarrjeve private dhe zhvillimin e tregjeve të kapitalit.

Neni 5 **Kompetencat**

1. Me qëllim përmbushjen e objektivit të saj, Korporata gëzon kompetencën për të kryer çdo aktivitet ekonomik ose financiar që është në pajtim me rregulloret e nxjerra nga bordi i drejtorëve të Korporatës.

2. Pa cenuar përgjithësimin e paragrafit 1 të saj, Korporata ka kompetencat e mëposhtme:

a) identifikon dhe promovon projektet e sektorit privat, të cilat plotësojnë kriteret e fizibilitetit dhe efektivitetit ekonomik, duke u dhënë përparësi projekteve që kanë një ose më shumë nga karakteristikat e mëposhtme:

i) nxisin zhvillimin dhe shfrytëzimin e burimeve njerëzore dhe materiale në vendet anëtare të Korporatës;

ii) japin stimuj për krijimin e vendeve të punës;

iii) promovojnë teknologjinë e informacionit;

iv) inkurajojnë kursimet dhe përdorimin e kapitalit në investime që prodhojnë mallra dhe shërbime;

v) kontribuojnë në gjenerimin dhe/ose kursimet e këmbimit valutor;

vi) nxisin kapacitetin menaxhues dhe transferimin e teknologjisë; dhe

vii) nxisin pronësi më të gjerë publike të ndërmarrjeve nëpërmjet pjesëmarrjes të sa më shumë investitorëve në kapitalin aksionar të këtyre ndërmarrjeve.

b) bën investime të drejtpërdrejta nëpërmjet instrumenteve islamike dhe mundësisht nëpërmjet pajtimit dhe blerjes së aksioneve ose instrumenteve të konvertueshme të borxhit në ndërmarrjet në të cilat një shumicë e fuqisë votuese mbahet nga investitorët me shtetësi në vendet anëtare. Për më tepër, në raste të kufizuara që duhet të miratohen nga bordi i drejtorëve, bën investime të drejtpërdrejta në ndërmarrje të vogla dhe të mesme që ndodhen në vendet anëtare, fuqia votuese e të cilave zotërohet në shumicë nga investitorët nga vende të tjera dhe në të cilat është i pranishëm gjenerimi i konsiderueshëm i vlerës lokale të shtuar që nuk është e disponueshme në formë tjetër;

c) ofron produkte dhe shërbime financiare që përfshijnë, por nuk kufizohen në instrumentet e interesave të pronësisë në formën e aksioneve të zakonshme me interesa të ndryshueshme dhe kategori të ngjashme me këtë të fundit, shitjet e kësteve të qirasë, istisna'a, salam, mudaraba, *murahaba* garanton dhe shërbimet e menaxhimit të riskut;

d) nxit pjesëmarrjen e burimeve të tjera të financimit dhe/ose ekspertizën nëpërmjet mjeteve të

përshtatshme, duke përfshirë organizimin e sindikatave, sigurimin e garancive dhe pjesëmarrjeve, ndërmarrjet e përbashkëta dhe forma të tjera shoqërie;

e) nxjerr *mudharaba*, qira dhe *istisna'a* obligacione dhe instrumente të tjera financiare;

f) nxit sigurimin e aksioneve dhe çështjeve të garancive dhe zgjeron këtë sigurim, me kusht që të plotësohen kushtet e përshtatshme, qoftë individualisht ose bashkërisht me ente të tjera financiare;

g) siguron shërbime të menaxhimit të aseteve për institucione dhe investitorë të tjerë në vendet anëtare;

h) ngre fonde dhe për atë qëllim jep këtë kolateral ose garanci tjetër sipas përcaktimit të Korporatës, me kusht që shuma totale e papaguar mbi fondet e ngritura ose garancitë e dhëna nga Korporata, pavarësisht nga burimi, të mos tejkalojë shumën e barabartë me trefishin e shumës së kapitalit të tij të pajtuar, mbivlerën dhe rezervat e fituara;

i) investon fonde që nuk nevojiten menjëherë në operacionet e saj financiare, si dhe fonde të mbajtura nga ajo për qëllime të tjera në këto detyrime dhe garanci të tregtueshme sipas përcaktimit të Korporatës;

j) siguron garanci në të cilat ka investuar me qëllim lehtësimin e shitjes së tyre;

k) blen dhe/ose shet garanci që ka lëshuar ose siguruar ose në të cilat ka investuar;

l) trajton sipas kushteve të vendosura nga Korporata, çdo çështje specifike në lidhje me punën e saj, siç mund t'i besohet Korporatës nga anëtarët e saj ose palët e treta dhe përmbush detyrat e administruesit të besuar në lidhje me trustet.

Neni 6

Politikat

Aktivitetet e Korporatës kryhen në pajtim me politikat e investimit që duhet të paraqiten të detajuara dhe të amenduara sipas kërkesës, në rregulloret e miratuara nga bordi i drejtorëve të Korporatës.

Neni 7

Anëtarët

1. Anëtarët themelues të Korporatës janë Banka, ato vende anëtare të Bankës dhe institucione të vendeve anëtare të cilat kanë nënshkruar këtë Marrëveshje deri në datën e specifikuar në paragrafin 1 të nenit 60, dhe që kanë bërë pagesën fillestare të kërkuar sipas nenit 10 të kësaj Marrëveshjeje.

2. Vendet e tjera anëtare të Bankës dhe institucionet e tjera financiare nga të cilat një vend anëtar ose vende anëtare të Bankës kanë zotërimin ose kontrollin kryesor, mund të aderojnë në këtë Marrëveshje në atë datë dhe në pajtim me kushtet që mund të caktojë asambleja e përgjithshme e Korporatës nga një shumicë e anëtarëve që përfaqësojnë të paktën dy të tretat e votave të përgjithshme të anëtarëve.

3. Asambleja e përgjithshme, në çdo kohë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, me një votë prej të paktën dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve që përfaqësojnë jo më pak se tre të katërtat e fuqisë votuese të anëtarëve, mund të hapë anëtarësimin e Korporatës në institucionet e sektorit privat në bazë të termave dhe kushteve që mund të caktojë.

KAPITULLI II

BURIMET FINANCIARE

Neni 8

Kapitali

1. Kapitali aksionar i autorizuar i Korporatës është 1 miliard dollarë amerikanë (1,000,000 US \$), nga të cilat pesëqind milionë dollarë amerikanë (500,000,000 US \$) vihen fillimisht në dispozicion për pajtim nga vendet themeluese. Banka pajton pesëdhjetë për qind të kësaj shume.

2. Kapitali aksionar i autorizuar ndahet në njëqind mijë (100,000) aksione, që kanë një vlerë nominale prej dhjetë mijë dollarësh amerikanë (10,000 US \$) secila. Çdo aksion që nuk pajtohet fillimisht nga vendet themeluese në pajtim me paragrafin 1 dhe 2 të Nenit 9 të kësaj Marrëveshjeje, vihet në dispozicion për pajtim të mëtejshëm.

3. Asambleja e Përgjithshme mund të rrisë kapitalin aksionar të autorizuar në këtë kohë dhe sipas termave dhe kushteve që mund të çmojë të përshtatshme, nga të paktën dy të tretat e numrit të përgjithshëm të anëtarëve, të cilët përfaqësojnë jo më pak se tre të katërtat e fuqisë votuese të anëtarëve.

Neni 9

Pajtimi

1. Banka dhe vendet anëtare themeluese pajtojnë fillimisht numrin e aksioneve të specifikuar në aneksin A të kësaj Marrëveshjeje.

2. Çdo anëtar tjetër themelues pajton të paktën njëqind aksione.

3. Aksionet fillimisht të pajtuara nga anëtarët themelues lëshohen me vlerë nominale.

4. Kushtet që rregullojnë pajtimin e aksioneve që duhet të lëshohen pas pajtimit fillestar të aksioneve nga anëtarët themelues që nuk janë pajtuar sipas nenit 8 (2), si dhe datat e pagesës së tyre përcaktohen nga asambleja e përgjithshme e korporatës.

5. Nëse asambleja e përgjithshme vendos të rrisë kapitalin aksionar të Korporatës, secili anëtar ka mundësi të arsyeshme të pajtohet, në bazë të termave dhe kushteve të vendosura nga asambleja e përgjithshme, në përqindjen e rritjes së aksioneve të barazvlefshme me përqindjen që kanë aksionet e saj të pajtuara deri para kësaj kohe kundrejt aksioneve të përgjithshme të pajtuara menjëherë përpara kësaj rritjeje. Asnjë anëtar nuk është i detyruar të pajtojë ndonjë pjesë të një rritjeje të kapitalit aksionar të Korporatës.

6. Në bazë të paragrafit 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme, me kërkesë të një anëtar, me vota të shumicës së numrit të përgjithshëm të anëtarëve që përfaqësojnë shumicën e fuqisë së përgjithshme votuese të anëtarëve, mund të rrisë pajtimin e këtij anëtar të kapitalit aksionar, në bazë të termave dhe kushteve të vendosura nga asambleja e përgjithshme.

Neni 10

Pagesa e pajtimeve

1. Banka paguan vlerën e aksioneve të pajtuara nga ajo në tre këste të njëpasnjëshme dhe të barabarta vjetore. Kësti i parë paguhet brenda tridhjetë ditëve pas datës kur Banka bëhet anëtare e Korporatës në pajtim me nenin 61 (2) të kësaj Marrëveshjeje. Secili prej kësteve të mbetura paguhet në përvjetorin e datës kur kësti i mëparshëm bëhet i kërkueshëm dhe i pagueshëm.

2. Në emër të secilit vend anëtar themelues, Banka paguan vlerën e aksioneve fillimisht të pajtuara nga ajo. Numri i kësteve dhe datat e pagesës së tyre përcaktohen nga bordi i drejtorëve të Korporatës me miratimin e bordit të drejtorëve ekzekutivë të bankës.

3. Çdo anëtar tjetër themelues paguan vlerën e aksioneve të pajtuara nga ajo në pesë këste të barabarta të njëpasnjëshme vjetore. Kësti i parë paguhet brenda tridhjetë ditëve pasi anëtar i themelues përkatës bëhet anëtar i Korporatës, në pajtim me Nenin 61 (2) të kësaj Marrëveshjeje. Secili prej kësteve të mbetura paguhet në përvjetorin e datës kur kësti i mëparshëm bëhet i kërkueshëm dhe i pagueshëm.

4. Vlera e aksioneve paguhet në dollarë amerikanë. Korporata përcakton vendin ose vendet e pagesës.

Neni 11

Kufizimet mbi transferimin dhe barra e aksioneve

Aksionet e Korporatës mund të mos mbahen peng, të vendosen si barrë ose transferohen në asnjë lloj mënyre përveçse për Korporatën, nëse asambleja e përgjithshme nuk miraton një transferim ndërmjet anëtarëve nga një shumicë e anëtarëve që përfaqësojnë dy të tretat e votave të përgjithshme të anëtarëve.

Neni 12

Kufizimi mbi përgjegjësinë

Përgjegjësia e anëtarëve, duke përfshirë Bankën, mbi aksionet e pajtuara nga ta, kufizohet në pjesën e papaguar të vlerës së tyre në lëshim. Asnjë anëtar, duke përfshirë Bankën, nuk është përgjegjës, për shkak të anëtarësisë së tij, për detyrimet e Korporatës.

Neni 13

Burime të tjera

Burime të tjera të Korporatës përbëhen nga:

a) shuma që rriten me anë të dividendëve, komisioneve dhe fondeve të tjera që rrjedhin nga investimet e Korporatës;

- b) shumat e marra nga shitja e investimeve ose shlyerja e financimit;
- c) shumat e mbledhura nga Korporata nëpërmjet instrumentave të ndryshme; dhe
- d) fonde të tjera që i besohen Korporatës për administrim.

KAPITULLI III OPERACIONET

Neni 14

Parimet operuese

1. Korporata siguron financim në bazë të termave dhe kushteve që çmon të përshtatshme sipas rrethanave, duke marrë në konsideratë kërkesat e ndërmarrjeve që duhet të financohen, rreziqet ndaj mjedisit, rreziqet e marra përsipër nga Korporata dhe termat dhe kushtet normalisht të siguruara nga investitorë privatë për financim të ngjashëm islamik.

2. Korporata kërkon të qarkullojë fondet e saj duke shitur instrumentet e veta, me kusht që kjo shitje të mund të bëhet në formë të përshtatshme dhe sipas kushteve të kënaqshme në shkallën e mundshme, në pajtim me nenin 5(2) (a) (vii).

3. Korporata kërkon të ruajë diversifikim të arsyeshëm në investimet e saj.

4. Korporata zbaton ato kritere financiare, teknike, ekonomike, ligjore, mjedisore dhe institucionale fizibiliteti dhe vlerësimi, siç mund të kërkohej për të justifikuar investimet dhe mjaftueshmërinë e garancive të ofruara.

5. Korporata kërkon përfaqësim në bordin e organeve të korporatës që financon ose investon nëse aksionet e saj në kapitalin e tyre nuk tejkalojnë pesë për qind të kapitalit të përgjithshëm të pajtuar.

6. Korporata nuk kryen asnjë operacion që hyn në kategorinë e investimeve, të cilën komiteti i *Shari'ah*-ut ka përmendur në nenin 29, që do të ishte i papajtueshëm me *Shari'ah*-un ose që Korporata e konsideron të papajtueshëm me këtë Marrëveshje ose me rregulloret të cilat duhet të nxirren sipas kësaj Marrëveshjeje.

7. Korporata nuk vendos si kusht që të ardhurat e financimit të saj të përdoren për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të cilat e kanë origjinën në një vend të paracaktuar.

8. Korporata nuk mban përgjegjësi për menaxhimin e ndonjë ndërmarrjeje në të cilën ka investuar dhe nuk ushtron të drejtat e saj votuese për këtë qëllim ose për ndonjë qëllim tjetër i cili, sipas mendimit të saj, hyn brenda fushës së veprimit të kontrollit menaxherial.

Neni 15

Kufizimet

1. Me përjashtim të investimit të aseteve likuide të Korporatës, të përmendura në nenin 5 (2) (1) të kësaj Marrëveshjeje, investimet e Korporatës bëhen vetëm në ndërmarrjet të cilat ndodhen në vendet anëtare ose që punojnë ekskluzivisht ose kryesisht në interes të vendeve anëtare; këto investime bëhen duke ndjekur rregulla të shëndosha të menaxhimit financiar.

2. Korporata nuk financon asnjë ndërmarrje në territorin e një vendi anëtar, nëse vendi anëtar e kundërshton një financim të tillë.

Neni 16

Mbrojtja e interesave

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk e pengon Korporatën nga ushtrimi i veprimeve dhe të drejtave që mund të çmojë të nevojshme për mbrojtjen e interesave të saj në rast të mosplotësimit të zotimeve në ndonjë prej investimeve ose financimeve të saj, paafësisë paguese aktuale ose të rrezikuar të ndërmarrjeve në të cilat janë bërë këto investime ose financime, ose situata të tjera të cilat, sipas mendimit të Korporatës, kërcënojnë këto investime ose financime.

Neni 17

Aktiviteti politik i ndaluar

Korporata, kryetari i bordit të saj të drejtorëve, anëtarët e bordit të drejtorëve, menaxheri i përgjithshëm, nëpunësit dhe stafi nuk ndërhyjnë në çështjet politike të ndonjë vendi anëtar; as nuk ndikohen në vendimet e tyre nga karakteri politik i vendit anëtar të interesuar.

KAPITULLI IV ORGANIZIMI DHE MENAXHIMI

Neni 18 **Struktura**

Korporata ka një asamble të përgjithshme, një bord drejtorësh, një komitet ekzekutiv, një bord këshillimor, një komitet *Shari'a*, kryetarin e bordit të drejtorëve, një menaxher të përgjithshëm, si dhe nëpunës dhe staf tjetër të nevojshëm për menaxhimin efikas të Korporatës brenda kufijve të autorizuar nga bordi i drejtorëve të korporatës.

Neni 19 **Asambleja e përgjithshme**

1. Secili anëtar përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme dhe emëron një përfaqësues, i cili shërben sipas dëshirës së anëtarit emërues.

2. Përfaqësuesit e anëtarëve në asamblenë e përgjithshme shërbejnë si të tillë pa u paguar nga Korporata, por Korporata mund t'i riimburojë ata për shpenzimet e arsyeshme të bëra në lidhje me pjesëmarrjen në mbledhje.

3. Asambleja e përgjithshme cakton një nga përfaqësuesit e vendeve anëtare si kryetar që do të rrijë në detyrë deri në zgjedhjen e kryetarit të ardhshëm në mbledhjen e ardhshme vjetore të asamblesë së përgjithshme.

Neni 20 **Asambleja e përgjithshme, kompetencat**

1. Të gjitha kompetencat e Korporatës jepen në asamblenë e përgjithshme.
2. Asambleja e Përgjithshme mund të delegojë ndonjë ose të gjitha kompetencat e saj në bordin e drejtorëve, përveç kompetencës:
 - a) për të pranuar anëtarë të rinj dhe për të përcaktuar kushtet e pranimi të tyre;
 - b) për të rritur ose për të zvogëluar kapitalin aksionar të Korporatës;
 - c) për të pezulluar një anëtar;
 - d) për të vendosur mbi apelime nga interpretimet ose aplikimet e kësaj Marrëveshjeje të dhëna nga bordi i drejtorëve;
 - e) për të miratuar pas rishikimit të raportit të audituesit, llogaritë përfundimtare të Korporatës;
 - f) për të zgjedhur anëtarët e bordit të drejtorëve;
 - g) për të caktuar rezervat dhe shpërndarjen e të ardhurave dhe mbivlerave neto të Korporatës;
 - h) për të angazhuar shërbimet e audituesve të jashtëm për të shqyrtuar llogaritë përfundimtare të Korporatës;
 - i) për të amenduar këtë Marrëveshje; dhe
 - j) për të vendosur për të pezulluar ose përfunduar operacionet e Korporatës dhe për të shpërndarë asetet e saj.
3. Asambleja e përgjithshme dhe bordi i drejtorëve, në shkallën që ky i fundit është i autorizuar, mund të miratojë ato rregulla dhe rregullore të përgjithshme që mund të jenë të nevojshme ose të përshtatshme për të zhvilluar biznesin e Korporatës, duke përfshirë rregullat dhe rregulloret për personelin, pensionet dhe përfitimet e tjera.
4. Asambleja e përgjithshme mund të krijojë një komitet dhe t'i besojë atij vlerësimin e performancës së Korporatës dhe paraqitjen e raporteve përkatëse për kryetarin e bordit të drejtorëve të korporatës.
5. Asambleja e përgjithshme ruan kompetenca të plota për të ushtruar autoritet mbi çdo çështje të deleguar për bordin e drejtorëve sipas paragrafëve (2) dhe (3) të këtij neni.

Neni 21 **Asambleja e përgjithshme, procedurat**

1. Asambleja e përgjithshme zhvillon një mbledhje vjetore që mbahet në lidhje me mbledhjen vjetore të bordit të guvernatorëve të Bankës. Kjo mund të zhvillohet në raste të tjera që asambleja e përgjithshme çmon të nevojshme ose organizohet nga bordi i drejtorëve. Bordi i Drejtorëve duhet të kërkojë një mbledhje të asamblesë së përgjithshme sa herë që kërkohet nga një e treta e anëtarëve të Korporatës.

2. Një shumicë e anëtarëve të asamblesë së përgjithshme përbën kuorum për çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, me kusht që kjo shumicë të përfaqësojë jo më pak se dy të tretat e fuqisë së përgjithshme votuese të anëtarëve.

3. Asambleja e përgjithshme, me anë të një rregulloreje, krijon një procedurë ku bordi i drejtorëve, kur e çmon këtë veprim të këshillueshëm, mund të marrë një votë të anëtarëve të asamblesë së përgjithshme mbi një çështje specifike pa organizuar një mbledhje të asamblesë së Përgjithshme.

Neni 22

Votimi

1. Secili anëtar ka një votë për çdo aksion të pajtuar dhe të paguar.

2. Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Marrëveshje, të gjitha çështjet para asamblesë së përgjithshme vendosen me një shumicë të fuqisë votuese të përfaqësuar në mbledhje.

Neni 23

Bordi i drejtorëve, përbërja

1. Bordi i drejtorëve përbëhet nga jo më pak se gjashtë dhe jo më shumë se dhjetë anëtarë përveç kryetarit të bordit të drejtorëve dhe menaxherit të përgjithshëm.

2. Banka emëron një ose më shumë anëtarë të bordit të drejtorëve, të cilët, së bashku me kryetarin e bordit të drejtorëve dhe menaxherin e përgjithshëm përbëjnë gjysmën e bordit të drejtorëve.

3. Një anëtar emërohet nga vendi anëtar që ka numrin më të madh të aksioneve të Korporatës.

4. Pjesa që mbetet e anëtarëve të bordit të drejtorëve zgjidhet nga anëtarët e ndryshëm nga anëtari që ka numrin më të madh të aksioneve.

5. Procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve parashtrohen në rregulloret të cilat duhet të miratohen nga asambleja e përgjithshme.

6. Anëtarët e bordit të drejtorëve emërohen ose zgjidhen për një periudhë prej tre vjetësh dhe mund të rizgjidhen. Anëtarët e zgjedhur të bordit të drejtorëve mund të rizgjidhen për jo më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme. Anëtarët e bordit të drejtorëve do të vazhdojnë të jenë në detyrë derisa të emërohen ose zgjidhen pasardhësit e tyre. Nëse zyra e një anëtari të bordit të Drejtorëve lirohet më shumë se nëntëdhjetë (90) ditë para përfundimit të mandatit, një pasardhës emërohet ose zgjidhet për pjesën e mbetur të mandatit nga anëtari ose anëtarët që emëruan ose zgjedhën ish anëtarin e bordit të drejtorëve, sipas rastit.

7. Anëtarët e bordit të drejtorëve duhet të jenë të kualifikuar në mënyrë të përshtatshme dhe me përvojë në fushat e aktiviteteve të Korporatës.

8. Asnjë anëtar i bordit të drejtorëve nuk mund të shërbejë njëkohësisht si anëtar i asamblesë së përgjithshme të korporatës.

9. Një anëtar i bordit të drejtorëve pushon që qënuri në detyrë nëse anëtari ose të gjithë anëtarët, votat e të cilëve janë marrë parasysh për emërimin ose zgjedhjen e tij, pushojnë së qenuri anëtarë të Korporatës.

Neni 24

Bordi i drejtorëve, kompetencat

Bordi i drejtorëve është përgjegjës për kryerjen e përgjithshme të operacioneve të Korporatës dhe për këtë qëllim ushtron të gjitha kompetencat e dhëna atij nga kjo Marrëveshje ose që i janë deleguar nga asambleja e përgjithshme. Në veçanti, bordi i drejtorëve, me rekomandim të kryetarit të bordit të drejtorëve:

- a) miraton politikat e Korporatës dhe rregullat dhe rregulloret e tij të përgjithshme;
- b) miraton strategjinë operacionale të Korporatës;
- c) miraton buxhetin administrativ vjetor;
- d) paraqet llogaritë përfundimtare për çdo vit financiar për miratim të asamblesë së përgjithshme;
- e) interpreton dispozitat e kësaj Marrëveshjeje;

f) i propozon amendime të kësaj Marrëveshjeje asamblesë së përgjithshme;
g) ndërmerr çdo veprim tjetër që nuk është i papajtueshëm me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje ose vendimet e asamblesë së përgjithshme, siç e çmon të përshtatshme për zhvillimin e biznesit të Korporatës ose për zhvillimin e mëtejshëm të qëllimeve të tij.

Neni 25

Bordi i drejtorëve, procedurat

1. Bordi i drejtorëve operon në selinë e Korporatës ose në vendndodhje tjetër që mund të përcaktohet nga bordi dhe mbledhet në rastet kur e kërkon biznesi i Korporatës.

2. Një shumicë e anëtarëve të bordit të drejtorëve përbën një kuorum për çdo mbledhje të bordit të drejtorëve, me kusht që kjo shumicë të përfaqësojë jo më pak se dy të tretat e fuqisë së përgjithshme votuese të anëtarëve.

3. Në bazë të paragrafit (4) të këtij neni, gjatë votimit në bordin e drejtorëve, secili anëtar i bordit të drejtorëve autorizohet të hedhë numrin e votave të cilat anëtari ose anëtarët e Korporatës votat e të cilëve numërohen për emërimin ose zgjedhjen e tij, janë të autorizuar të hedhë.

4. Anëtarët e bordit të drejtorëve të emëruar nga Banka ndajnë në mënyrë të barabartë ndërmjet tyre votat e Bankës.

5. Përveç rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë Marrëveshje, të gjitha çështjet para bordit të drejtorëve vendosen nga një shumicë e fuqisë votuese të përfaqësuar në mbledhje.

6. Të gjitha votat që një anëtar i bordit të drejtorëve është i autorizuar të hedhë, hidhen si një njësi.

7. Në rast barazimi të votave, kryetari ka të drejtën të hedhë votën vendimtare në bord.

Neni 26

Komiteti ekzekutiv

1. Komiteti ekzekutiv përbëhet si më poshtë:

a) Kryetari i bordit të drejtorëve;

b) Menaxheri i përgjithshëm i Korporatës;

c) Anëtari i bordit të drejtorëve i emëruar nga vendi anëtar që ka numrin më të madh të aksioneve në Korporatë;

d) Jo më pak se dy dhe jo më shumë se katër anëtarë ndërmjet anëtarëve të bordit të drejtorëve që përfaqësojnë anëtarë të tjerë, siç përcaktohet nga bordi i drejtorëve.

2. Kryetari i bordit të drejtorëve dhe në mungesë të tij, menaxheri i përgjithshëm i Korporatës kryeson mbledhjen e komitetit ekzekutiv dhe nuk ka asnjë votë kur drejton mbledhjen përveç një vote vendimtare në rast të barazimit të votave.

Neni 27

Komiteti ekzekutiv, funksionet

Pa cenuar nenin 31 (5), komiteti ka kompetencën për të miratuar të gjitha financimet dhe investimet nga Korporata në ndërmarrjet në vendet anëtare dhe ushtron kompetenca të tjera që i delegohen nga bordi i drejtorëve.

Neni 28

Komiteti ekzekutiv, procedurat

1. Të gjitha financimet dhe investimet kërkojnë një miratim të votës së shumicës të anëtarëve të komitetit që marrin pjesë në votim. Një mungesë ose abstenim nuk merret parasysh në votim.

2. Një kuorum për çdo mbledhje të Komitetit është prania e shumicës së anëtarëve të tij.

3. Një raport në lidhje me çdo operacion të miratuar nga komiteti i paraqitet bordit të drejtorëve. Me kërkesë të një anëtari të bordit të drejtorëve, ky operacion i paraqitet bordit për votë. Në mungesë të kësaj kërkesë, brenda tridhjetë ditësh të shpërndarjes për bordin, një operacion konsiderohet i miratuar nga Bordi.

4. Në rast të një barazimi votash në lidhje me një operacion të propozuar, ky propozim i kthehet menaxhimit për rishikim dhe analizë të mëtejshme; nëse pas rishqyrtimit në komitet, një barazim votash ndodh sërish, kryetari ka të drejtën për të hedhur votën vendimtare në Komitet.

5. Në rast se komiteti kundërshton operacionin, informon anëtarët e bordit të drejtorëve që, me kërkesë të çdo anëtari të bordit të drejtorëve, mund të kërkojë që një raport menaxhimi mbi këtë operacion, së bashku me një përmbledhje të rishikimit të komitetit, t'i dorëzohen bordit për diskutim dhe direktiva të mundshme në lidhje me çështjet teknike dhe të politikave mbi operacionin dhe operacione të ngjashme në të ardhmen.

Neni 29

Komiteti i Shari'a-ut

1. Korporata ka një komitet *Shari'a-u* që përbëhet nga tre akademikë eruditë islamikë, me njohuri të mira për transaksionet financiare. Anëtarët e komitetit emërohen nga bordi i drejtorëve për një mandat të rinovueshëm prej tre vjetësh.

2. Komiteti i *Shari'a-ut* jep orientime nëse një kategori e caktuar investimi është e pajtueshme për *Shari'a-un* dhe shqyrton çdo çështje që i është referuar nga bordi i drejtorëve ose komiteti ekzekutiv, ose menaxhimi i Korporatës.

3. Komiteti merr vendimin e tij pasi shqyrton pikëpamjet e menaxhimit dhe të ndonjë eksperti mbi çështje që mund të dëshirojë t'i konsultojë.

4. Vendimet e komitetit të *Shari'a-ut* merren me shumicë votash nga anëtarët e tij dhe parashtrihen argumentet dhe arsyet mbi të cilat është bazuar.

Neni 30

Bordi Këshillimor

1. Korporata mund të ketë një bord këshillimor, që përbëhet nga pesë personalitete të kombësive të ndryshme, të njohur në nivel ndërkombëtar, të cilët janë ekspertë në fushat e aktiviteteve të Korporatës.

2. Anëtarët e bordit këshillimor emërohen nga asambleja e përgjithshme për një mandat të rinovueshëm prej tre vjetësh.

3. Bordi këshillimor shkëmben pikëpamje dhe paraqet raporte mbi çdo çështje të paraqitur atij nga asambleja e përgjithshme, bordi i drejtorëve, komiteti ekzekutiv, kryetari i bordit të drejtorëve ose menaxheri i përgjithshëm. Të gjitha pikëpamjet e shprehura në bordin këshillimor reflektohen në raportet e tij.

Neni 31

Kryetari, menaxheri i përgjithshëm dhe nëpunësit

1. Presidenti i Bankës është kryetari i zgjedhur kryesisht i bordit të drejtorëve të korporatës. Ai kryeson mbledhjet e bordit të drejtorëve, por ka të drejtë vote, përveç rasteve të një barazimi votash. Ai merr pjesë në mbledhjet e asamblesë së përgjithshme, por nuk voton në këto mbledhje.

2. Menaxheri i përgjithshëm emërohet nga bordi i drejtorëve pas rekomandimit të kryetarit të bordit të drejtorëve. Menaxheri i përgjithshëm është shtetas i një vendi anëtar. Bordi i drejtorëve përcakton periudhën e qëndrimit në detyrë, e cila mund të jetë e rinovueshme, të menaxherit të përgjithshëm dhe kushtet e emërimit të tij.

3. Menaxheri i përgjithshëm është shefi ekzekutiv i Korporatës dhe nën mbikëqyrjen e përgjithshme të kryetarit të bordit të drejtorëve, zhvillon biznesin aktual të Korporatës. Menaxheri i përgjithshëm është përgjegjës për organizimin, emërimin dhe shkarkimin e nëpunësve dhe stafit në pajtim me rregullat dhe rregulloret e miratuara nga Korporata.

4. Menaxheri i përgjithshëm është anëtar i bordit të drejtorëve dhe komitetit ekzekutiv pa të drejtë vote, përveç rasteve të një barazimi votash ndërsa ai vepron si kryetar.

5. Në shkallën që autorizohet nga bordi i drejtorëve, menaxheri i përgjithshëm miraton financimet dhe investimet nga Korporata në ndërmarrjet në vendet anëtare.

6. Sa herë që duhet të kryhen aktivitete të cilat kërkojnë njohuri të specializuara ose që nuk mund të trajtohen nga stafi i brendshëm i Korporatës, mund të përfshihen përkohësisht shërbimet e ekspertëve dhe konsulentëve.

7. Nëpunësit dhe stafi i Korporatës ia kushtojnë tërësisht detyrën e tyre Korporatës në përmbushje të funksioneve të tyre. Secili anëtar i Korporatës respekton karakterin ndërkombëtar të kësaj detyre dhe frenohet nga të gjitha përpjekjet për të ndikuar në ndonjë prej tyre gjatë përmbushjes së detyrave të tyre.

8. Korporata i kushton vëmendjen e duhur nevojës për të siguruar standardet më të larta të efikasitetit, kompetencës dhe integritetit profesional dhe etik, si konsideratë të rëndësishme në emërimin e

stafit të Korporatës dhe në vendosjen e kushteve të tyre të shërbimit. Gjithashtu, vëmendje duhur i kushtohet rëndësisë së rekrutimit të stafit mbi një bazë gjeografike sa më të gjerë që të jetë e mundur.

Neni 32

Publikimi i raporteve vjetore dhe qarkullimi i raporteve

1. Korporata publikon një raport vjetor që përmban një deklaratë të audituar të llogarive të saj. Ajo u dërgon gjithashtu anëtarëve një përmbledhje tremujore të gjendes së saj financiare dhe një deklaratë fitimesh dhe humbesh që tregon rezultatet e operacioneve të saj.

2. Më tej, Korporata mund të publikojë çdo raport dhe studim tjetër që mund të konsiderojë të përshtatshëm, me qëllim përmbushjen e qëllimeve dhe funksioneve të saj.

Neni 33

Dividendët

1. Asambleja e përgjithshme përcakton se cila pjesë e të ardhurave neto dhe mbivlerës së Korporatës, pas marrjes së masave për rezervat, do të shpërndahet si dividendë. Në çdo rast, asnjë dividend nuk do të shpërndahet para se rezervat të arrijnë njëzet e pesë për qind (25 %) të kapitalit të pajtuar.

2. Dividendët shpërndahen proporcionalisht me kapitalin aksionar të paguar, të mbajtur nga secili anëtar.

3. Dividendët paguhen në atë mënyrë dhe në atë monedhë ose monedha që cakton asambleja e përgjithshme.

Neni 34

Marrëdhëniet me Bankën

1. Korporata është një ent i ndarë dhe i dallueshëm nga Banka. Fondet dhe llogaritë e Korporatës ruhen të ndara dhe veçmas nga ato të Bankës, megjithëse dy organizatat mund të bashkëfinancojnë të njëjtin projekt dhe të investojnë bashkarisht fondet e tyre, me kusht që ato të regjistrohen veçmas në regjistrat e tyre përkatës. Dispozitat e këtij paragrafi nuk e pengojnë Korporatën të bëjë marrëveshje me Bankën në lidhje me ambientet, personelin, shërbimet dhe çështje të tjera mbi shpenzimet e riimbursimit dhe ato administrative të paguara nga secila organizatë në përfitim të tjetrës.

2. Korporata kërkon sipas mundësisë të shfrytëzojë ambientet dhe vendqëndrimet e Bankës për një konsideratë që mund të bihet dakord me Bankën.

3. Asgjë në këtë Marrëveshje nuk e bën Korporatën përgjegjëse për veprimet ose detyrimet e Bankës ose nuk e bën Bankën përgjegjëse për veprimet ose detyrimet e Korporatës.

KAPITULLI V

TËRHEQJA DHE PEZULLIMI I ANËTARËVE

Neni 35

E drejta e tërheqjes

1. Çdo anëtar mund të tërhiqet nga Korporata duke njoftuar me shkrim kryetarin e bordit të drejtorëve mbi synimin e tij për ta bërë këtë. Kjo tërheqje hyn në fuqi në datën e specifikuar në njoftim por në asnjë rast jo para gjashtë muajve nga data në të cilën ky njoftim i është dorëzuar Korporatës. Në çdo kohë para se tërheqja të hyjë në fuqi, pas njoftimit me shkrim për Korporatën, anëtari mund të heqë dorë nga synimi i tij për t'u tërhequr.

2. Një anëtar që është tërhequr mbetet përgjegjës për të gjitha detyrimet ndaj Korporatës për të cilat ai ishte objekt në datën e dorëzimit të njoftimit të tërheqjes. Megjithatë, nëse tërheqja hyn në fuqi, një anëtar nuk mban përgjegjësi për detyrimet që rrjedhin nga operacionet e Korporatës, të kryera pas datës në të cilën njoftimi i tërheqjes është marrë nga ky i fundit.

Neni 36

Pezullimi i anëtarësimit

1. Një anëtar që dështon në përmbushjen e detyrimeve të tij ndaj Korporatës mund të pezullohet nga një votë që përfaqëson jo më pak se tre të katërtat e fuqisë së përgjithshme votuese të anëtarëve.

2. Një anëtar i pezulluar në këtë mënyrë pushon automatikisht së qenuri anëtar i Korporatës një vit nga data e pezullimit të tij, nëse asambleja e përgjithshme gjatë kësaj periudhe nuk vendos me shumicën e përmendur në paragrafin (1) të këtij neni për të shtyrë ose hequr pezullimin.

3. Ndërsa ndodhet nën pezullim, një anëtar nuk mund të ushtrojë asnjë nga të drejtat e dhëna atij nga kjo Marrëveshje, përveç të drejtës së tërheqjes, por do të mbetet objekt i plotësimit të të gjitha detyrimeve.

Neni 37

Të drejtat dhe detyrat mbi ndërprerjen e anëtarësisë

1. Nga koha që ndërpritet anëtarësia e tij, një anëtar nuk do të ndajë më fitimet ose humbjet e Korporatës dhe nuk do të mbajë asnjë përgjegjësi në lidhje me financimin dhe garancitë e dhëna nga Korporata në një kohë të mëpasshme. Korporata kujdeset për riblerjen e kapitalit aksionar të këtij anëtari si pjesë të shlyerjes së llogarive me të, në pajtim me dispozitat e këtij neni.

2. Korporata dhe një anëtar mund të bien dakord mbi tërheqjen nga anëtarësia dhe riblerjen e aksioneve të anëtarit të larpërmendur mbi kushte të përshtatshme, sipas rrethanave. Nëse kjo marrëveshje nuk arrihet brenda tre muajve pas datës në të cilën ky anëtar shpreh dëshirën për t'u tërhequr nga anëtarësia ose brenda një afati të rënë dakord ndërmjet të dyja palëve, çmimi i riblerjes së aksioneve të anëtarit do të jetë i barabartë me vlerën e tij kontabël në datën kur anëtari nuk i përket më Korporatës, kjo vlerë kontabël duhet të përcaktohet nga deklaratat e fundit financiare të audituara të Korporatës.

3. Pagesa për aksionet bëhet në këstet, kohën dhe monedhat e disponueshme të përcaktuara nga Korporata, duke marrë në konsideratë gjendjen e saj financiare. Me kusht që pagesa e çmimit të riblerjes së aksioneve të alokuara sipas kësaj Marrëveshjeje ndaj një ish vendi anëtar dhe paguar në emër të tij sipas nenit 10 (2) nga Banka, do të bëhet për Bankën.

4. Asnjë shumë që duhet t'i paguhet një ish anëtari për aksionet e tij sipas këtij neni nuk mund të paguhet deri në një muaj pas datës në të cilën ky anëtar pushon që qenuri anëtar i Korporatës. Nëse brenda asaj periudhe, Korporata pezullon operacionet, të drejtat e këtij anëtari përcaktohen nga dispozitat e nenit 38 dhe anëtari ende konsiderohet anëtar i Korporatës për qëllime të nenit të mësipërm, me përjashtim të faktit që ai nuk do të ketë të drejtë vote.

Neni 38

Pezullimi i operacioneve

Në rast emergjence, bordi i drejtorëve mund të pezullojë operacione në lidhje me investimet, financimet dhe garancitë e reja deri në kohën që asambleja e përgjithshme të ketë mundësinë për të shqyrtuar situatën dhe për të marrë masat përkatëse.

Neni 39

Përfundimi i operacioneve

1. Korporata mund të përfundojë operacionet e saj me vendim të asamblesë së përgjithshme të marrë nga një shumicë prej dy të tretash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve që përfaqësojnë të paktën tre të katërtat e votave të përgjithshme të anëtarëve. Me përfundimin e operacioneve, Korporata ndërpret menjëherë të gjitha aktivitetet, me përjashtim të atyre që kanë lidhje me ruajtjen, mbrojtjen dhe realizimin e aseteve të tij dhe shlyerjen e detyrimeve të tij.

2. Deri në shlyerjen përfundimtare të këtyre detyrimeve dhe shpërndarjen e aseteve, Korporata do të ekzistojë ende dhe të gjitha të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të Korporatës dhe anëtarëve të saj sipas kësaj Marrëveshjeje do të vazhdojnë të jenë të pacënuara, me përjashtim të faktit që asnjë anëtar nuk do të pezullohet ose tërhiqet dhe nuk do të bëhet asnjë shpërndarje për anëtarët, përveç rasteve të parashikuara në këtë Nen.

Neni 40

Përgjegjësia e anëtarëve dhe pagesat e detyrimeve

1. Përgjegjësia e anëtarëve që lind nga pajtimet e kapitalit mbetet në fuqi derisa detyrimet e

Korporatës, duke përfshirë detyrimet e paparashikuara, të shlyhen plotësisht.

2. Të gjithë kreditorët që kanë detyrime të drejtpërdrejta të paguara nga asetet e Korporatës, së cilës i faturohen këto detyrime dhe më pas nga rezervat e tjera dhe më tej nga kapitali i shlyer dhe më pas nga pagesat, nëse ka të pagueshme për Korporatën mbi pajtimet e kapitalit të papaguar të cilit i faturohen këto detyrime. Para bërjes së këtyre pagesave për kreditorët që kanë detyrime të drejtpërdrejta, bordi i drejtorëve merr masa të nevojshme, sipas mendimit të tij, për të siguruar një shpërndarje proporcionale ndërmjet zotëruesve të detyrimeve të drejtpërdrejta dhe të mundshme.

Neni 41

Shpërndarja e aseteve

1. Nuk bëhet asnjë shpërndarje e aseteve për anëtarët në bazë të pajtimeve të paguara për kapitalin aksionar të Korporatës derisa të përmbushen ose parashikohen të gjitha përgjegjësitë për kreditorët. Kjo shpërndarje duhet të miratohet nga asambleja e përgjithshme me një votë prej dy të tretash të numrit të përgjithshëm të aëntarëve që përfaqësojnë jo më pak se tre të katërtat e fuqisë së përgjithshme votuese të anëtarëve.

2. Asnjë shpërndarje e aseteve për anëtarët nuk është në përpjesëtim me kapitalin aksionar të shlyer të mbajtur dhe bëhet në ato kohë dhe në ato kushte që Korporata i çmon të drejta dhe të paanshme. Përqindjet e aseteve të shpërndara nuk kanë nevojë të jenë uniforme me tipin e aseteve. Asnjë anëtar nuk autorizohet të marrë përqindjen tij në këtë shpërndarje të aseteve derisa të ketë shlyer të gjitha detyrimet ndaj Korporatës.

3. Çdo anëtar që merr asetet e shpërndara sipas këtij neni, gëzon të njëjtat të drejta në lidhje me këto asete që Korporata ka gëzuar para shpërndarjes së tyre.

KAPITULLI VI

IMUNITETET DHE PRIVILEGJET

Neni 42

Qëllimi i kapitullit

Për të mundësuar Korporatën të përmbushë funksionet të cilat i janë besuar, imunitetet dhe privilegjet e parashtruara në këtë kapitull i jepen Korporatës në territoret e secilit vend anëtar.

Neni 43

Qëndrimi i Korporatës në lidhje me procesin gjyqësor

1. Akuza kundër Korporatës mund të ngrihen vetëm në një gjykatë me juridiksion kompetent në territoret e një vendi anëtar në të cilin Korporata ka një zyrë, ka emëruar një agjent për qëllim të pranimit të shërbimit ose njoftimit të procesit ose ka nxjerrë apo siguruar garanci.

2. Megjithatë nuk do të ngrihet asnjë akuzë kundër Korporatës nga anëtarë ose persona që veprojnë ose që nxjerrin pretendime nga anëtarë, as për çështje personale.

3. Prona dhe asetet e Korporatës, kudo që ndodhen dhe nga kushdo që mbahen, imunizohen nga të gjitha format e sekuestrimit gjyqësor, sekuestrimi ose ekzekutimi para dhënies së një vendimi të formës së prerë kundër Korporatës.

Neni 44

Imuniteti i aseteve nga sekuestrimi

Prona dhe asetet e Korporatës, kudo që ndodhen dhe nga kushdo që zotërohen, imunizohen nga kërkimi, përdorimi, konfiskimi, shpronësimi ose çdo formë tjetër konfiskimi me anë të veprimit ekzekutiv ose legjislativ.

Neni 45

Imuniteti i arkivave

Arkivat e korporatës janë të paprekshme.

Neni 46

Fshehtësia e depozitave

Korporata zbaton fshehtësi të plotë në lidhje me llogaritë e depozituesve dhe anëtarët respektojnë pacenueshmërinë e informacionit në lidhje me këto depozita.

Neni 47

Liria e aseteve nga kufizimet

1. Në bazë të paragrafit 2 të këtij neni dhe në shkallën e nevojshme për të kryer operacionet e parashikuara në këtë Marrëveshje, të gjitha pronat dhe asetet e Korporatës janë të lira nga kufizimet, rregulloret, kontrollet dhe moratoriumet e çdo natyre.

2. Fondet e marra nga ose të pagueshme për Korporatën në lidhje me një investim të Korporatës të bërë në ndonjë territor të shtetit anëtar sipas neni 4 (1) të kësaj Marrëveshjeje nuk janë të lira, vetëm për shkak të ndonjë dispozite të kësaj Marrëveshjeje, nga kufizimet përgjithësisht të zbatueshme të këmbimit valutor, rregulloret dhe kontrollet në fuqi në territoret e vendit anëtar.

Neni 48

Privilegjet për komunikime

Secili vend anëtar i jep trajtim të barabartë komunikimeve zyrtare të Korporatës me atë që i jep komunikimeve zyrtare të vendeve të tjera anëtare.

Neni 49

Imunitetet dhe privilegjet e nëpunësve dhe punonjësve

Të gjithë anëtarët e asamblesë së përgjithshme, kryetari dhe anëtarët e bordit të drejtorëve, menaxheri i përgjithshëm, nëpunësit dhe punonjësit e Korporatës:

- i) imunizohen nga procesi ligjor në lidhje me veprimet e kryera nga ta në cilësinë e tyre zyrtare;
- ii) atyre që nuk janë shtetas vendas u jepen të njëjtat imunitete nga kufizimet e emigrimit, kërkesat e regjistrimit të shtetasve të huaj dhe detyrimet e shërbimit kombëtar dhe të njëjtat lehtësira në lidhje me kufizimet e shkëmbimit siç u jepen nga vendet anëtare përfaqësuesve, nëpunësve dhe punonjësve të një rangu të ngjashëm të vendeve të tjera anëtare.
- iii) u jepet i njëjti trajtim në lidhje me lehtësirat e udhëtimit siç u jepet nga vendet anëtare përfaqësuesve, nëpunësve dhe punonjësve të një rangu të ngjashëm të vendeve të tjera anëtare.

Neni 50

Imunitetet nga tatimi

1. Korporata, asetet e saj, prona, të ardhurat dhe operacionet dhe transaksionet e saj të autorizuar nga kjo Marrëveshje imunizohen nga të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore. Korporata gjithashtu imunizohet nga përgjegjësia për mbledhjen ose pagesën e ndonjë takse ose detyrimi.

2. Asnjë taksë nuk vendoset mbi ose në lidhje me pagat dhe rrogat e paguara nga Korporata për kryetarin ose anëtarët e bordit të drejtorëve, menaxheri i përgjithshëm, nëpunësit ose punonjësit e Korporatës.

3. Asnjë tatim i asnjë lloji nuk vendoset mbi ndonjë detyrim ose garanci të lëshuar nga Korporata (duke përfshirë çdo dividend ose kthim mbi të) nga kushdo zotërues:

- a) që paragjykon këtë detyrim ose garanci vetëm sepse është lëshuar nga Korporata; ose
- b) nëse baza e vetme juridiksionale për këtë tatim është vendi ose monedha në të cilën është lëshuar, bërë e pagueshme ose e paguar, ose vendndodhja e çdo zyre ose vendi biznesi të mbajtur nga Korporata.

4. Asnjë tatim i asnjë lloji nuk vendoset mbi ndonjë detyrim ose garanci të siguruar nga Korporata (duke përfshirë çdo dividend ose kthim mbi të) nga kushdo zotërues:

- a) që paragjykon këtë detyrim ose garanci vetëm sepse është siguruar nga Korporata; ose
- b) nëse baza e vetme juridiksionale për këtë tatim është vendndodhja e ndonjë zyre ose vendi biznesi të mbajtur nga Korporata.

Neni 51

Zbatimi i kapitullit

Secili vend anëtar merr masa të nevojshme në territoret e veta për qëllim të bërjes efektive, në lidhje me ligjin e saj, të parimeve të parashtruara në këtë kapitull dhe informon Korporatën mbi veprimin e detajuar që është ndërmarrë.

Neni 52
Heqja dorë

Korporata, sipas zgjedhjes së saj, mund të heqë dorë nga privilegjet dhe imunitetet e dhëna sipas këtij neni në shkallën dhe kushtet që mund të vendosë.

KAPITULLI VII
AMENDIMET, INTERPRETIMI, ARBITRAZHI

Neni 53
Amendimet

1. Kjo Marrëveshje mund të amendohet me anë të një vendimi të asamblesë së përgjithshme të marrë nga një votë prej dy të tretash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve që përfaqësojnë jo më pak se tre të katërtat e fuqisë së përgjithshme votuese të anëtarëve.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni, marrëveshja e njëzëshme e Asamblesë së Përgjithshme kërkohet për miratim të çdo amendimi që ndryshon:

- a) të drejtën për t'u tërhequr nga Korporata të parashikuar në Nenin 35 (1) të kësaj Marrëveshjeje.
 - b) të drejtën për të pajtuar aksione në rritjen e kapitalit të Korporatës të parashikuar në paragrafin (5) të nenit 9; dhe
- kufizimet mbi përgjegjësinë, të parashikuar në nenin 12.

3. Çdo propozim për të amenduar këtë Marrëveshje, qoftë kur rrjedh nga një anëtar i Korporatës ose bordi i drejtorëve, i komunikohet kryetarit të asamblesë së përgjithshme, i cili ia parashtron propozimin asamblesë së përgjithshme. Kur miratohet një amendim, Korporata e vërteton këtë në një komunikim zyrtar të drejtuar të gjithë anëtarëve. Amendimet hyjnë në fuqi për të gjithë anëtarët tre muaj pas datës së komunikimit zyrtar, përveç rasteve kur asambleja e përgjithshme nuk specifikon një datë të ndryshme.

Neni 54
Gjuha, interpretimi dhe zbatimi

1. Gjuha zyrtare e Korporatës është arabishtja. Përveç kësaj, gjuha angleze dhe frënge mund të përdoren si gjuhë pune. Teksti në gjuhën arabe i kësaj Marrëveshjeje është teksti origjinal për interpretim dhe zbatim.

2. Çdo çështje interpretimi e dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, që lind ndërmjet çdo anëtari dhe Korporatës ose ndërmjet anëtarëve, i parashtron bordit të drejtorëve për vendim.

3. Në çdo rast kur bordi i drejtorëve ka dhënë një vendim sipas paragrafit 2 të këtij neni, secili anëtar mund të kërkojë që çështja t'i paraqitet asamblesë së përgjithshme, vendimi i së cilës do të jetë i formës së prerë. Në pritje të vendimit të asamblesë së përgjithshme, Korporata, për aq sa e çmon të nevojshme, mund të veprojë në bazë të vendimit të bordit të drejtorëve.

Neni 55
Arbitrazhi

Nëse një mosmarrëveshje duhet të lindë ndërmjet Korporatës dhe një anëtari që ka pushuar së qenuri i tillë, ose ndërmjet Korporatës dhe çdo anëtari pas miratimit të një vendimi për të përfunduar operacionet e Korporatës, kjo mosmarrëveshje i paraqitet arbitrazhit nga një gjykatë prej tre arbitrash. Njëri prej arbitrave emërohet nga Korporata, një tjetër nga anëtari i interesuar, secila palë vepron brenda gjashtëdhjetë ditësh nga data e kërkesës për arbitrazh. Arbitri i tretë emërohet me marrëveshje të dy palëve dhe kur ata nuk arrijnë të bien dakord brenda 60 ditësh, nga kryetari aktual i Gjykatës Islamike të Drejtësisë, i cili emëron gjithashtu arbitrin që nuk është emëruar nga një palë në periudhën e specifikuar më sipër, me kërkesë të palës tjetër. Nëse dështojnë të gjitha përpjekjet për të arritur një vendim unianim nga arbitrat, vendimet arrihen me një shumicë votash të tre arbitrave. Arbitri i tretë autorizohet të zgjidhë të gjitha çështjet ose procedurën në çdo rast kur palët kanë mosmarrëveshje në lidhje me këtë.

Neni 56

Miratimi që konsiderohet i dhënë

Kurdoherë që kërkohet miratimi i ndonjë anëtari para se të kryhet ndonjë veprim nga Korporata, miratimi konsiderohet të jetë dhënë nëse anëtari nuk paraqet kundërshtim brenda një periudhe të tillë të arsyeshme që Korporata mund të vendosë në njoftimin e aktit të propozuar anëtarit.

KAPITULLI VIII

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 57

Selia e Korporatës

1. Selia e Korporatës është selia e Bankës në Jeddah në Mbretërinë e Arabisë Saudite.
2. Bordi i drejtorëve të Korporatës mund të vendosë zyrat e tjera në territoret e ndonjë prej vendeve anëtare.

Neni 58

Viti financiar

Viti financiar i bankës është viti financiar i korporatës.

Neni 59

Kanalet e komunikimit, depozitarët

1. Secili anëtar cakton një zyrë specifike të vetën për qëllime të komunikimit me Korporatën mbi çështje që lidhen me këtë Marrëveshje.
2. Secili vend anëtar cakton bankën e tij qendrore ose ndonjë agjenci tjetër që mund të bihet dakord me Korporatën, si depozitar me të cilin Korporata mund të ruajë aksionet e valutës së atij anëtari, si dhe asetet e tjera të Korporatës.

KAPITULLI IX

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 60

Nënshkrimi dhe pranimi

1. Kjo Marrëveshje depozitohet pranë Bankës ku mbetet e hapur për nënshkrim nga përfaqësuesit e Bankës, vendet anëtare të Bankës të renditura në aneksin A dhe anëtarë të tjerë potencialë deri në Dhul Hija 1420 të tridhjetë (të kalendarit hijra) që i korrespondon datës 5 prill 2000 (të kalendarit gregorian) ose një date të mëvonshme siç vendoset nga Bordi i Drejtorëve të Korporatës. Secili nënshkrues i kësaj Marrëveshjeje depoziton pranë Bankës një instrument që parashtron se ka pranuar ose ratifikuar këtë Marrëveshje në pajtim me ligjet ose rregulloret e veta dhe ka marrë hapat e nevojshme për ta mundësuar të përmbushë të gjitha detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.
2. Banka u dërgon kopje të vërtetuara të kësaj Marrëveshjeje të gjithë anëtarëve dhe i njofton ata rregullisht për çdo nënshkrim dhe depozitim të instrumentit të pranimi ose ratifikimit të bërë sipas paragrafit të mësipërm, si dhe datën përkatëse.
3. Në datën ose pas datës kur Korporata fillon operacionin, Banka mund të marrë nënshkrimin dhe instrumentin e pranimi të kësaj Marrëveshjeje nga çdo vend ose institucion, anëtarësimi i të cilave është miratuar në pajtim me paragrafin (2) të nenit 7 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 61

Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi kur të jetë nënshkruar dhe të jenë depozituar instrumentet e pranimi ose ratifikimit, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 60, nga:
 - a) Banka;
 - b) vendi i selisë; dhe
 - c) të paktën katër vende të tjera anëtare.
2. Vendet dhe institucionet, instrumentet e pranimi ose ratifikimit të të cilëve janë depozituar para datës kur Marrëveshja ka hyrë në fuqi, bëhen anëtare në atë datë. Vende dhe institucione të tjera bëhen

anëtare në datat në të cilat janë depozituar instrumentet e tyre të pranimit ose ratifikimit.

Neni 62

Fillimi i operacioneve

Sapo kjo Marrëveshje të hyjë në fuqi sipas paragrafit 1 të nenit 61, secili anëtar do të emërojë një përfaqësues dhe presidenti i bankës do të organizojë një mbledhje të asamblesë së përgjithshme. Korporata do të fillojë operacionet në datën kur do të zhvillohet kjo mbledhje.

Bërë në qytetin e Jeddah, Mbretëria e Arabisë Saudite, në një origjinal të vetëm, në datën 26 Rajab 1420H që i korrespondon datës 3 nëntor 1999, në gjuhën arabe, me përkthim në gjuhën angleze dhe frënge, që mbeten të depozituara në arkivat e Bankës Islamike për Zhvillim, e cila ka treguar me anë të nënshkrimit të saj poshtë marrëveshjes së saj, të veprojë si depozitar i kësaj Marrëveshjeje dhe të njoftojë të gjitha ato qeveri të vendeve emrat e të cilëve përcaktohen në aneksin A, për datën kur kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 61 të kësaj Marrëveshjeje.

ANEKSI A

AKSIONET NË KAPITALIN AKSIONAR TË AUTORIZUAR TË KORPORATËS TË ALOKUAR PËR PAJTIMIN FILLESTAR TË BANKËS ISLAMIKE PËR ZHVILLIM DHE VENDET ANËTARE

(Aksionet me vlerë nominale: 10,000 US \$ secila)

Aksionari	Numri i aksioneve
Afganistan	17
Ajzerbaxhan	4
Algjeri	475
Arabi Saudite	3,812
Bahrein	44
Bangladesh	188
Banka Islamike për Zhvillim	25,000
Benin	18
Brunei Darussalam	47
Burkina Faso	48
Çad	11
Egjipt	401
Gabon	51
Gambia	16
Guinea	47
Guinea Bisao	13
Indonezi	475
Irak	82
Iran	1,337
Jemen	95
Jordani	76
Kamerun	40
Katar	188
Kazakistan	3
Kirkistan	3
Komoros	4
Kuvajt	1,899
Liban	19
Libi	2,016
Malajzi	304
Maldivë	16
Mali	19
Marok	95
Mauritani	16
Mozambik	14
Nigeri	39

Oman	53
Pakistan	475
Palestinë	26
Senegal	47
Shqipëri	7
Sierra Leone	6
Siri	19
Somali	16
Sudan	63
Surinam	5
Taxhikistan	3
Togo	3
Tunizi	38
Turkmenistan	3
Turqi	1,176
UAE	1,082
Uganda	39
Xhibut	10
Totali	40,003

PAJTIMI FILLESTAR NË KAPITALIN AKSIONAR TË AUTORIZUAR

Data gregoriane Hijri	Emri dhe funksioni i nënshkruesit të autorizuar	Numri i aksioneve të pajtuara	Anëtarët	Numri
(E palexueshme)	(E palex.) Firma	25,000	Banka Islamike për Zhvillim	1
30.05.200 (E palex.)	Abdul Razique Samadi Zv/Ministër i Financave	17	Shteti Islamik i Afganistanit	2
04.06.2008(E palex)	Z. Sherefedin Shehu, zëvendësministër i Financave	7	Republika e Shqipërisë	3
(E palex)99 1420.7.25	(E palex.) Firma	475	Republika Demokratike dhe Popullore e Algjerisë	4
03.11.99 1420.7.25	Firma Z. Avaz Akbar Oglu Alekperov Ministër i Financave	4	Republika e Ajzerbajxhanit	5

LIGJ

Nr.10 106, datë 30.3.2009

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA NË LIGJIN NR. 8873, DATË 29.3.2002 “PËR SIGURIMIN E DEPOZITAVE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8873, datë 29.3.2002 “Për sigurimin e depozitave” bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 2 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

- a) Shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:
“c) “Akt nënligjor” është akti i Autoritetit Mbikëqyrës dhe/ose këshillit drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, i dalë në bazë dhe për zbatim të këtij ligji.”.
- b) Shkronja “d” ndryshohet si më poshtë:
“d) Bankë e siguruar” është banka apo dega e bankës së huaj në Shqipëri që pranon depozita të siguruara nga Agjencia.
- c) Shkronja “e” ndryshohet si më poshtë:
“e) “Degë e bankës së huaj në Shqipëri” ka kuptimin e përcaktuar në paragrafin e parë të pikës 15 të nenit 4 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.”.
- ç) Shkronja “f” ndryshohet si më poshtë:
“f) “Depozitë” është:
 - i) teprica kreditore, e cila rezulton nga fondet e depozituara në një llogari ose në njërën nga gjendjet e përkohshme, që rrjedhin nga veprimet e zakonshme bankare dhe që banka duhet t’i ripagujë, sipas dispozitave të një kontrate ose dispozitave ligjore;
 - ii) çdo detyrim i vërtetuar nëpërmjet një dokumenti apo vërtetimi të lëshuar nga banka ose dega e bankës së huaj;”.
- d) Pas shkronjës “m” shtohet shkronja “n” me këtë përmbajtje:
“n) “Dita e vlerësimit” është dita kur kryhet përlllogaritja e depozitave të siguruara, për efekt të përlllogaritjes së primit.”.

Neni 2

Në nenin 4 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

- a) Në pikën 4, fjalët “deri në procesin e transformimit, mbeten të siguruara” zëvendësohen me fjalët “mbeten të siguruara, për secilën bankë pjesëmarrëse në këtë proces, tre muaj prej datës që Agjencia njoftohet me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës për përfundimin e procesit të transformimit.”.
- b) Pas pikës 4 shtohet pika 4.1 me këtë përmbajtje:
“4.1. Në rastin e likuidimit vullnetar të bankës së siguruar, depozitat mbeten të siguruara, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, deri në përfundim të këtij procesi. Në çdo rast, Agjencia kompenson depozitat vetëm pas njoftimit, me shkrim, nga Autoriteti Mbikëqyrës për ndërhyrjen në bankën e siguruar.”.

Neni 3

Në nenin 5 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- a) Shkronja “a” ndryshohet si më poshtë:
“a) pjesa e depozitës mbi 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë ose shuma e barasvlershme me të (kundërvleftën), në monedhë të huaj.”.
- b) Shkronja “d” ndryshohet si më poshtë:
“d) depozitat e personave, të cilët kryejnë detyrën e auditimit dhe certifikimin e llogarive kontabël në bankat e siguruara, si dhe depozituesit me të njëjtin status në shoqëritë e tjera të të njëjtit grup.”.

Neni 4

Në nenin 6 bëhen këto ndryshime e shtesa:

- a) Pikat 1 dhe 2 ndryshohen si më poshtë:
 - “1. Agjencia kompenson depozitat e siguruara, kur Autoriteti Mbikëqyrës ndërhyr në bankën e siguruar, ose kur kjo e fundit likuidohet vullnetarisht.
 - 2. Agjencia kompenson depozitën e siguruar, sipas dispozitave të këtij ligji, në masën 100 për qind

dhe, në çdo rast, jo më shumë se 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë, për çdo depozitues në çdo bankë të siguruar, që operon në Republikën e Shqipërisë, pavarësisht numrit të depozitave apo shumës së depozituar.”.

b) Në pikën 4, pas shkronjës “c” shtohen shkronjat “ç”, “d”, “dh” dhe “e” me këtë përmbajtje:

“ç) në rastin e depozitave të përbashkëta, pjesa përkatëse e secilit prej depozituesve merret parasysh në llogaritjen e shumës së përgjithshme të depozitave që ka depozituesi në bankën e siguruar. Përveç rasteve kur përcaktohet ndryshe në kushtet e vendosjes së depozitës, çdo depozitues prezumohet se zotëron pjesë të barabarta në depozitën e përbashkët;

d) në rastin e depozitave të vendosura si garanci për një person të tretë, të drejtat për kompensim të depozitës i njihen titullarit të depozitës, në përputhje me specifikimet e nënpikës “i” të shkronjës “dh” të kësaj pike. Në rastin e depozitave të vendosura në përfitim të një personi të tretë, të drejtat për kompensim të depozitës i njihen këtij të fundit, në përputhje me specifikimet e nënpikës “ii” të shkronjës “dh” të kësaj pike. Në rastin e depozitës së vendosur në përfitim ose si garanci të më shumë se një personi të tretë, zbatohen rregullat e parashikuara për depozitat e përbashkëta;

dh) në rastin e depozitave të vendosura në përfitim ose si garanci të personit ose të personave të tretë, shuma e depozitës/depozitave në fjalë merret parasysh në llogaritjen e shumës së përgjithshme të depozitave, që ka depozituesi në bankën e siguruar;

i) në rastin e depozitave që shërbejnë si garanci, shuma e kompensimit për këtë depozitë nuk do t’i paguhet titullarit të depozitës deri në çastin kur ai është liruar nga detyrimi i garancisë. Në rast se titullari nuk arrin të lirohet nga detyrimi i garancisë, shuma e kompensimit përfitohet nga personi i tretë, në favor të të cilit është vendosur garancia;

ii) në rastin e depozitave të vendosura me kusht ose me afat në përfitim të personit të tretë, ky i fundit përfiton shumën e kompensimit me përfundimin e afatit ose me plotësimin e kushtit përkatës. Në të kundërt, shuma e kompensimit përfitohet nga titullari i depozitës ose trashëgimtarët e tij;

e) në rast se ka një vendim gjyqësor për subjektin, që përfiton kompensimin e depozitave të përmendura në shkronjat “ç”, “d” e “dh” të këtij neni, Agjencia kryen kompensimin, në përputhje me këtë vendim gjyqësor.”.

c) Pas pikës 5 shtohet pika 5.1 me këtë përmbajtje:

“5/1. Me përfundimin e afatit ligjor të procesit të kompensimit, fondi i mbetur i kompensimit për depozitat e siguruar, i përbërë nga shumat e kompensimit që mbeten të pushlyera deri në përfundim të këtij afati, transferohen prej Agjencisë në një llogari të veçantë pranë Autoritetit Mbikëqyrës. Në përputhje me dispozitat e këtij ligji, depozituesit mund të paraqiten në çdo kohë pranë Agjencisë për tërheqjen e shumës së kompensimit.”.

Neni 5

Në nenin 7, pikat 1, 2 e 3 ndryshohen si më poshtë:

“1. Kompensimi për llogari të depozitave të siguruar fillon menjëherë pasi Agjencia njoftohet, me shkrim, nga Autoriteti Mbikëqyrës për ndërhyrjen ose për vendimin e likuidimit vullnetar të bankës së siguruar. Kompensimi përfundon jo më vonë se tre muaj nga data e fillimit të procesit të kompensimit.

Në raste të veçanta, këshilli drejtues i Agjencisë i kërkon Autoritetit Mbikëqyrës të vendosë përjashtimisht zgjatjen e afatit të kryerjes së kompensimit, por jo më shumë se dy herë për periudha tremujore.

2. Agjencia kompenson depozitën e siguruar si më poshtë:

a) nëpërmjet njohjes së të drejtës së kthimit të fondeve për shumën e depozituar dhe të transferuar në një bankë tjetër të siguruar, deri në nivelin e kompensimit, sipas dispozitave të këtij ligji;

b) nëpërmjet pagimit të shumës në lekë personit, sipas nivelit të kompensimit;

c) nëpërmjet një banke të siguruar. Kriteret e përzgjedhjes së bankës së siguruar propozohen nga këshilli drejtues i Agjencisë dhe miratohen me akt nënligjor nga Autoriteti Mbikëqyrës. Banka e siguruar, që do të kryejë procesin e kompensimit, caktohet me vendim të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë, në përputhje me kriteret e përzgjedhjes, të përcaktuara në aktin nënligjor përkatës të Autoritetit Mbikëqyrës.

3. Kur shuma, që kërkohet për kompensimin e depozitave të siguruar, është më e madhe se mjetet financiare të zotëruara nga Agjencia, atëherë kjo e fundit mund të marrë hua nga Buxheti i Shtetit. Ministria e Financave është institucioni që lidh marrëveshje me Agjencinë dhe Bankën e Shqipërisë për kushtet e huasë që jepet nga Buxheti i Shtetit, për pagesën e shumës së kompensimit. Masa e huasë së dhënë përcaktohet në mënyrë që kapaciteti financiar i Agjencisë të jetë në proporcion me detyrimet e saj dhe, në çdo rast, nuk duhet të rrezikojë qëndrueshmërinë e sistemit bankar në vend. Interesi i huasë nuk duhet të

jetë më i ulët se normat e interesit, të miratuara nga Autoriteti Mbikëqyrës, në bazë të normave të interesit për tituj të tregtueshëm në Shqipëri, me maturitet të krahasueshëm.”.

Neni 6

Neni 9 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 9

Të drejtat dhe detyrimet e Agjencisë dhe bankave të siguruara

1. Agjencia kompenson depozitat e siguruara deri në nivelin dhe sipas procedurave të përcaktuara në këtë ligj dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

2. Agjencia përgjigjet për administrimin e fondeve me efektivitet dhe në përputhje me standardet e pranura të menaxhimit të riskut.

3. Bankat e siguruara, me kërkesë të Agjencisë, dërgojnë pranë saj, sa herë që u kërkohen, informacione dhe dokumentacione për veprimtarinë, sipas dispozitave të këtij ligji, në veçanti për depozitat dhe depozituesit, metodologjinë e përlllogaritjes së primit dhe kontributit fillestar.

4. Në procedurat e kujdestarisë dhe të likuidimit, Agjencia, në veçanti, merr informacione të hollësishme për depozitat dhe depozituesit, të cilët përfitojnë nga skema e sigurimit të depozitave, sipas dispozitave të këtij ligji.

5. Agjencia ka të drejtë të ankimojë raportin e likuidatorit tek Autoriteti Mbikëqyrës, kur vëren se veprimet e propozuara nga ai, sipas ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, janë në kundërshtim me interesat e ligjshëm të saj.

6. Agjencia, nëse e çmon të nevojshme, sigurohet për saktësinë dhe integritetin e informacioneve dhe dokumentacioneve të lartpërmendura edhe nëpërmjet verifikimeve të kryera drejtpërsëdrejti në bankat e siguruara. Agjencia, në mënyrë të veçantë, verifikon te bankat e siguruara saktësinë e përlllogaritjes së primit, të të dhënave identifikuese të depozituesve dhe depozitave për efekt kompensimi, si dhe për saktësinë e informimit të publikut për skemën e sigurimit.

7. Në mbikëqyrjen e bankave, në procesin e kujdestarisë dhe të likuidimit, Autoriteti Mbikëqyrës mbron interesat e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe i jep asaj të dhëna, të cilat i shërbejnë për të kryer veprimtarinë e saj.

8. Agjencia, sipas rastit, kërkon nga Autoriteti Mbikëqyrës përfshirjen e përfaqësuesve të vet në ekzaminimet, që Autoriteti Mbikëqyrës kryen në bankat e siguruara.

9. Bankat e siguruara detyrohen të krijojnë sisteme për ruajtjen e të dhënave për llogaritjen e primit të sigurimit të depozitave, në përputhje me kërkesat e Agjencisë, të cilat përcaktohen me akt nënligjor.

10. Bankat e siguruara detyrohen të mbajnë informacion për depozitat dhe depozituesit, në përputhje me kërkesat e Agjencisë, që përcaktohen me akt nënligjor.

11. Agjencia shkëmben informacione dhe hyn në marrëveshje bashkëpunimi, në bazë reciprociteti, për përmbushjen e funksioneve të saj, me organizatat përgjegjëse homologe të vendeve të tjera.”.

Neni 7

Në nenin 11, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Këshilli ka këto kompetenca:

- a) vendos për kompensimin e depozitave të siguruara, sipas dispozitave të këtij ligji;
- b) vendos për politikat e sigurimit të depozitave, në përputhje me këtë ligj;
- c) vendos për politikat e administrimit të mjeteve financiare të agjencisë;
- ç) vendos për pranimin dhe përjashtimin e bankave në sigurimin e depozitave, sipas dispozitave të këtij ligji;
- d) mund të propozojë shtyrjen e afatit për kryerjen e procesit të kompensimit, sipas dispozitave të këtij ligji;
- dh) përcakton primet vjetore të bankave të siguruara, në përputhje me këtë ligj;
- e) përcakton kontributet fillestare të bankave të siguruara, në përputhje me këtë ligj;
- ë) propozon për Autoritetin Mbikëqyrës akte nënligjore, me efekt për subjektet pjesëmarrëse në skemën e sigurimit të depozitave;
- f) i propozon Këshillit të Ministrave një rritje të fondit themeltar dhe miraton kreditë, huatë, subvencionet ose donacionet për Agjencinë;
- g) propozon shkarkimin e anëtarëve të këshillit drejtues, në përputhje me nenin 13 të këtij ligji;
- gj) shqyrton projektbuxhetin e Agjencisë, cakton nivelin e pagave për Drejtorin e Përgjithshëm dhe

personelin e Agjencisë, si dhe për shpërblimin e anëtarëve të këshillit drejtues, që ia paraqet për miratim Autoritetit Mbikëqyrës;

- h) miraton kontrollorët e brendshëm dhe të jashtëm të Agjencisë dhe shqyrton raportet e tyre;
- i) mbikëqyr veprimtarinë e Drejtorit të Përgjithshëm;
- j) miraton raportet dhe rekomandimet për publikim;
- k) miraton bilancin vjetor, raportet vjetore dhe raportet e tjera financiare të Agjencisë;
- l) miraton programet vjetore të punës së Agjencisë;
- ll) miraton të gjitha aktet nënligjore, që rregullojnë funksionimin e brendshëm të Agjencisë, në veçanti:

- i) statutin;
- ii) rregulloren e marrëdhënieve të punës së personelit;
- iii) rregulloren për procedurat e mbledhjeve të këshillit drejtues;
- iv) strukturën organizative;
- v) rregulloret e brendshme të funksionimit të njësive organizative të Agjencisë;
- iv) rregullat dhe procedurat e delegimit të kompetencave apo përgjegjësië.”.

Neni 8

Pas nenit 16 shtohet neni 16/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 16/1

Mbrojtja ligjore gjatë ushtrimit të detyrës

1. Agjencia, punonjësit e saj dhe anëtarët e këshillit drejtues nuk janë përgjegjës për dëmet e shkaktuara të tretëve, nga veprimet ose mosveprimet e kryera gjatë ushtrimit të detyrës funksionale dhe përmbushjes së përgjegjësië të tyre ligjore, të përcaktuara në këtë ligj.

2. Punonjësit e Agjencisë dhe anëtarët e këshillit drejtues, përjashtimisht, mund të përgjigjen për dëmet që u shkaktojnë personave fizikë ose juridikë, privatë, vetëm kur provohet se ata kanë vepruar me keqbesim.

3. Në rastet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni, Agjencia, pasi dëmshpërblen palën e dëmtuar, ka të drejtë të kërkojë nga punonjësi fajtor kthimin e shpërbimit që ka paguar.

4. Në rastet kur punonjësi i paditur, në bazë të pikës 2 të këtij neni, deklarohet se nuk ka përgjegjësi, me vendim të formës së prerë të gjykatës përkatëse, Agjencia është e detyruar t’i rimburojë atij shumën e plotë të shpenzimeve, që ai ka kryer për të realizuar përfaqësimin dhe mbrojtjen e tij ligjore.

5. Dispozitat e ligjit nr.8510, datë 15.7.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore” nuk zbatohen për të përcaktuar përgjegjësinë jashtëkontraktore të Agjencisë, si dhe të organeve apo punonjësve të saj.”.

Neni 9

Në nenin 20, pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) rimarrje nga likuidimet.”.

Neni 10

Pas nenit 20 shtohet neni 20/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 20/1

Mjetet financiare shitesë në rast të pamjaftueshmërisë së fondeve

1. Kur shuma që kërkohet për kompensimin e depozitave të siguruara është më e madhe se mjetet financiare të zotëruara, në kuptim të nenit 20 të këtij ligji, atëherë, me propozimin e këshillit drejtues dhe me miratimin e Autoritetit Mbikëqyrës, pamjaftueshmëria e fondeve mbulohet nëpërmjet njërës prej këtyre mënyrave:

a) bankat e siguruara, në përputhje me pikën 8 të nenit 24 të këtij ligji, detyrohen të paguajnë primin vjetor para afatit ligjor, duke marrë për bazë të llogaritjes së primit mesataren aritmetike të shumës së depozitave të siguruara, që janë regjistruar në bankë në ditën e fundit të muajit pararendës;

b) rritjes së primit vjetor të pagueshëm nga bankat e siguruara deri në nivelin e përcaktuar në pikën 3 të nenit 24 të këtij ligji.

2. Shuma e primit të paguar para afatit ligjor nga bankat e siguruara, në përputhje me shkronjën “a” të pikës 1 të këtij neni, zbritet nga shuma e primit vjetor, që banka e siguruar duhet të paguajë në vitin

pasardhës. Nëse shuma e primit të paguar para afatit ligjor është më e madhe se shuma e primit vjetor, që banka e siguruar duhet të paguajë në vitin pasardhës, atëherë diferenca i rimbursohet bankës së siguruar.

3. Huatë apo kreditë e marra nga Agjencia, sipas nenit 20 të këtij ligji, për mbulimin e pamjaftueshmërisë së fondeve, garantohen me një garanci të lëshuar nga Autoriteti Mbikëqyrës ose nga vetë Agjencia, duke përdorur asetet e saj apo pretendimet e ardhshme të Agjencisë për pagimin e primit vjetor nga bankat e siguruara.

4. Nëse mjetet financiare të siguruara sipas nenit 20 të këtij ligji dhe pikës 1 të këtij neni nuk janë të mjaftueshme, atëherë përdoren mjete financiare nga Buxheti i Shtetit.”.

Neni 11

Në nenin 21 bëhen këto shtesa:

a) Në shkronjën “ç” të pikës 1, pas fjalës “depozitë” shtohen fjalët “me interes”.

b) Pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Me qëllim sigurimin e fondeve të mjaftueshme për procesin e kompensimit, Agjencia mund të shesë, me detyrim riblerjen e tyre, instrumente të detyrimeve, të emetuara nga Ministria e Financave për Bankën e Shqipërisë, sipas kushteve të miratuara nga këshilli drejtues i Agjencisë dhe Autoriteti Mbikëqyrës.”.

Neni 12

Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 23

Pranimi dhe përfundimi i sigurimit të depozitave

1. Subjektet, që kanë marrë miratimin paraprak për licencë nga Autoriteti Mbikëqyrës, brenda 12 muajve, bashkëpunojnë me Agjencinë për përgatitjen e kushteve teknike dhe organizative për plotësimin e kushtit për sigurimin e depozitave.

2. Subjektet, të cilat aplikojnë për marrjen e licencës, për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë, pranë Autoritetit Mbikëqyrës, paraqesin njëkohësisht edhe kërkesën për pranimin në skemën e sigurimit të depozitave pranë Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

3. Kërkesa dhe dokumentacioni i nevojshëm për pranimin në skemën e sigurimit të depozitave rregullohet me akt nënligjor të Agjencisë.

4. Autoriteti Mbikëqyrës bashkëpunon me Agjencinë për shqyrtimin e kërkesës së subjektit që kërkon të licencohet, për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Shqipërisë. Autoriteti Mbikëqyrës licencën subjektin, që kërkon të operojë si bankë, vetëm pasi ka administruar më parë opinionin e Agjencisë për kërkesën e kryer. Autoriteti Mbikëqyrës informon Agjencinë për dhënien e licencës bankare brenda tri ditëve nga marrja e vendimit.

5. Banka e siguruar, që ka marrë miratimin paraprak nga Autoriteti Mbikëqyrës për ndryshimin e emrit, transformimin e saj nëpërmjet bashkimit, shkrirjes apo çdo forme tjetër të riorganizimit juridik, paraqet menjëherë kërkesën pranë Agjencisë për pajisje me certifikatë të re të sigurimit të depozitave. Agjencia pasqyron ndryshimin në certifikatën e sigurimit të depozitave brenda dy ditëve nga data e regjistrimit të vendimit përkatës të transformimit në regjistrin tregtar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

6. Agjencia pranon kërkesën për sigurimin e depozitave të bankës së re jo më vonë se tri ditë nga data e marrjes së njoftimit me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës për dhënien e licencës bankare. Me pranimin e kërkesës, Agjencia lëshon certifikatë për sigurimin e depozitave.

7. Çdo bankë e siguruar, kërkesa e së cilës pranohet nga Agjencia, sipas dispozitave të këtij ligji, paguan kontribut fillestar në Agjenci jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga dhënia e licencës bankare nga Autoriteti Mbikëqyrës. Kontributi fillestar është 0,5 për qind e kapitalit të nënshkruar të bankës. Kontributi fillestar paguhet njëherësh, në lekë, në llogarinë e Agjencisë, në Autoritetin Mbikëqyrës. Këshilli drejtues i Agjencisë mund të vendosë përjashtimin nga detyrimi për pagesën e kontributit fillestar për bankat e reja, të cilat krijohen duke marrë përsipër depozitat dhe detyrimet e një banke të siguruar ekzistuese.

8. Sigurimi i depozitës në bankën e siguruar përfundohet nga Agjencia, kur Autoriteti Mbikëqyrës njofton me shkrim:

a) ndërhyrjen në bankën e siguruar;

b) revokimin e licencës bankare të bankës së siguruar.

9. Agjencia, jo më vonë se 24 orë nga vendimi për përfundimin e sigurimit të depozitës së bankës, njofton, me shkrim, Autoritetin Mbikëqyrës dhe bankën e siguruar. Njoftimi i Agjencisë botohet në Fletoren Zyrtare dhe, të paktën, në një gazetë kombëtare me tirazhin më të madh.”.

Neni 13

Në nenin 24 bëhen këto ndryshime:

a) Pas pikës 2 shtohet pika 2.1 me këtë përmbajtje:

“2.1. Për qëllim të përlogaritjes së primit, depozitat në valutë konvertohen në lekë, sipas kursit zyrtar të këmbimit, të përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës në ditën e vlerësimit.”.

b) Në fjalinë e dytë të pikës 7, pas fjalëve “Autoritetit Mbikëqyrës” shtohen fjalët “dhe Agjencia e Sigurimit të Depozitave”.

Neni 14

Në nenin 25, në fund të pikës 2 shtohen fjalët “përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj”.

Neni 15

Në nenin 26, pikat 2 e 3 ndryshohen si më poshtë:

“2. Autoriteti Mbikëqyrës merr ndaj bankës së siguruar masat ndëshkimore, të parashikuara në ligjin nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të propozuara nga Agjencia, në rastet kur:

a) nuk paguan kontributin dhe primin vjetor, sipas afateve ligjore;

b) me gjithë kërkesën e Agjencisë, përlogarit primin në kundërshtim me formulën e përcaktuar në ligj;

c) deklaroon dhe komunikoon të dhëna të pavërteta e të gabuara;

ç) u komunikoon depozituesve dhe të tretëve të dhëna të pavërteta ose të pasakta, sipas nenit 30 të këtij ligji;

d) publikoon dhe informoon për sigurimin e depozitave, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

3. Në rastet e përmendura në pikën 2 të këtij neni, përveç masave ndëshkimore, Autoriteti Mbikëqyrës mund të zbatojë dhe një ose disa nga masat e mëposhtme, pavarësisht nga renditja e tyre:

a) urdhëron bankën e siguruar për pushimin e menjëhershëm të veprimeve, të konsideruara si kundërvajtje dhe marrjen e masave korrigjuese;

b) urdhëron bankën e siguruar që, përveç masës së përmendur në shkronjën “a” të kësaj pike, t’i paguajë Agjencisë fitimin e munguar për mospagimin në kohë të kontributit fillestar dhe të primit të parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj. Masa e fitimit të munguar përlogaritet në bazë të shumës së primit të papaguar, numrit të ditëve të vonesës, me interes të barabartë me interesin bazë, të përcaktuar nga Autoriteti Mbikëqyrës për periudhën kur është vënë re vonesa.”.

Neni 16

Neni 31 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 31

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, llogaritja e primit vjetor të sigurimit të depozitave për vitin 2009, për çdo bankë të siguruar, anëtare ekzistuese në skemën e sigurimit të depozitave, do të bëhet sipas depozitave ekzistuese ligjore.”.

Neni 17

Në nenin 32, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Aktet nënligjore të Agjencisë, me efekt për subjektet pjesëmarrëse në skemën e sigurimit të depozitave, botohen në Fletoren Zyrtare.”.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6128, datë 8.4.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 107, datë 30.3.2009

PËR KUJDESIN SHËNDETËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti dhe fusha e zbatimit të ligjit

1. Ky ligj përcakton parimet kryesore dhe kuadrin ligjor për rregullimin, organizimin dhe funksionimin e sistemit të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë.

2. Ky ligj zbatohet nga të gjithë personat fizikë ose juridikë, shqiptarë ose të huaj, të cilët veprojnë në sistemin e kujdesit shëndetësor.

Neni 2

Parimet e kujdesit shëndetësor

Kujdesi shëndetësor udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

- a) e drejta për kujdes shëndetësor është një e drejtë themelore e individit;
- b) garantimi i të drejtave të barabarta në kujdesin shëndetësor, bazuar në mosdiskriminim;
- c) sistemi i kujdesit shëndetësor funksionon mbështetur në efikasitetin dhe cilësinë e shërbimit, duke garantuar sigurinë e pacientit dhe paanësinë;
- ç) pjesëmarrja e aktorëve të ndryshëm, pacientëve, konsumatorëve dhe qytetarëve;
- d) llogaridhënia ndaj qytetarëve.

Neni 3

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- 1. “Autoritetet shëndetësore” janë Ministria e Shëndetësisë dhe strukturat rajonale në varësi të saj.
- 2. “Ofruesit e kujdesit shëndetësor” janë personat publikë ose privatë, fizikë ose juridikë, si dhe organizatat jofitimprurëse, të cilët janë të regjistruar nga Ministria e Shëndetësisë, për të siguruar kujdes shëndetësor në përputhje me këtë ligj.
- 3. “Kujdesi shëndetësor” është tërësia e masave dhe veprimtarive të ndërmarra nga institucionet e kujdesit shëndetësor, punonjës shëndetësorë dhe shtetas, me qëllim përmirësimin e mirëqenies së përgjithshme fizike, mendore dhe sociale të shtetasve.
- 4. “Shëndeti” është gjendja shëndetësore e plotë fizike, mendore dhe sociale, siç përcaktohet në Kushtetutën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.
- 5. “Konfidencialiteti profesional” është ruajtja e të dhënave për gjendjen shëndetësore të pacientit ndaj personave të paautorizuar.
- 6. “Shërbimet e kujdesit shëndetësor” janë ndërhyrjet mjekësore për të rritur mbrojtjen dhe trajtimin shëndetësor, nëpërmjet parandalimit, diagnostikimit, masave kurative dhe rehabilituese, të

siguruara nga ana e ofruesve të regjistruar të kujdesit shëndetësor.

7. “Sistemi i kujdesit shëndetësor” është organizimi, financimi dhe shpërndarja e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, ku përfshihen: promovimi dhe parandalimi shëndetësor; shërbimi diagnostikues, terapeutik dhe rehabilitues; politikat e kujdesit shëndetësor, ligjet, rregulloret dhe standardet për zbatimin e politikave dhe bashkëveprimet të qeverisë qendrore, vendore dhe ofruesve publikë ose privatë të shërbimeve shëndetësore.

8. “Kujdesi shëndetësor parësor” është tërësia e masave dhe e veprimtarive të ndërmarra nga një rrjet profesionistësh dhe institucioneve shëndetësore, që ofrojnë shërbimin bazë mjekësor për popullatën.

9. “Promovimi shëndetësor” është procesi i dhënies së mundësisë qytetarëve, për të rritur kontrollin dhe për të përmirësuar shëndetin e tyre.

10. “Profesionistë shëndetësorë” janë personat e pajisur me dijet e nevojshme shkencore dhe profesionale, që ushtrojnë profesionin në fusha dhe profile të ndryshme të sistemit shëndetësor.

11. “Urgjenca mjekësore” është një dëmtim ose sëmundje akute dhe që përbën një rrezik të menjëhershëm të jetës së personit apo të shëndetit të mëtejshëm të tij.

12. “Gjendja e emergjencës shëndetësore” është një situatë e papritur fatkeqësie, e tillë si epidemia ose fatkeqësia natyrore ose njerëzore, që rrezikojnë jetën, integritetin fizik dhe shëndetin e shtetasve, ose që çrregullon funksionimin e institucioneve shëndetësore dhe që shpallet nga Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrisë së Shëndetësisë për një periudhë të përcaktuar kohe.

KREU II PËRGJEGJËSITË E SHËNDETIT DHE TË SHËTETASVE

Neni 4 Përgjegjësitë e shtetit

1. Shteti ushtron veprimtarinë e tij lidhur me kujdesin shëndetësor në mbështetje të këtij ligji dhe zotohet për të rregulluar dhënien, mbikëqyrjen dhe administrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor.

2. Shteti mbron parimin e solidaritetit në financimin dhe sigurimin e kujdesit shëndetësor.

3. Ministri i Shëndetësisë drejton politikën, organizimin dhe mbikëqyrjen e sistemit të kujdesit shëndetësor.

4. Ministria e Shëndetësisë përgatit strategjinë e sistemit të kujdesit shëndetësor, e cila përfshin politika dhe programe përkatëse të shëndetësisë dhe protokolle kombëtare të trajtimit.

5. Ministri i Shëndetësisë harton politika për edukimin e vazhdueshëm profesional të burimeve njerëzore në kujdesin shëndetësor.

6. Ministri i Shëndetësisë është përgjegjës për evidentimin dhe koordinimin e çështjeve ndërsektoriale që lidhen me shëndetin publik.

7. Ministri i Shëndetësisë ngre komisione ose grupe pune të posaçme për ta asistuar atë për çështje të caktuara.

8. Programet dhe veprimtaritë e shëndetit publik financohen nga Buxheti i Shtetit dhe çdo burim tjetër i përcaktuar me ligj të veçantë.

Neni 5 Përgjegjësitë dhe të drejtat e pushtetit vendor

1. Në zbatim të legjisllacionit në fuqi për qeverisjen vendore dhe të këtij ligji, njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse për sa më poshtë:

- a) krijimin dhe ruajtjen e një mjedisi të shëndetshëm brenda juridiksionit të territorit të tyre;
- b) administrimin e objekteve të shërbimit të kujdesit shëndetësor, të cilat janë në pronësi të tyre;
- c) përfshirjen në politikat dhe organizmat drejtues të institucioneve shëndetësore brenda juridiksionit të tyre;

ç) dhënien e kontributeve financiare për institucionet shëndetësore brenda juridiksionit të tyre.

2. Bashkitë dhe komunat ushtrojnë kontroll administrativ për veprimtarinë shëndetësore në territorin që administrojnë, në përputhje me legjisllacionin në fuqi, në koordinim me Ministrinë e

Shëndetësisë.

3. Bashkitë dhe komunat, në koordinim me Ministrinë e Shëndetësisë, marrin masa për të siguruar shërbime të kujdesit shëndetësor parësor për popullatën brenda juridiksionit të komunës ose bashkisë.

Neni 6

Përgjegjësitë dhe të drejtat e shtetasve

1. Çdo shtetas është përgjegjës për:
 - a) ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit vetjak dhe të komunitetit;
 - b) respektimin e së drejtës së tjetrit, që ka të bëjë me ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit, parandalimin e sëmundjeve, si dhe me riaftësimin pas tyre;
 - c) shmangien, në hapësirat publike, të mënyrave të sjelljes dhe të veprimtarive, të cilat, në bazë të studimeve të bëra për këtë qëllim, njihen si të rrezikshme, për sa i përket shëndetit të tjerëve;
 - ç) dhënien e ndihmesës në financimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, nëpërmjet kontributeve të sigurimit shëndetësor të detyrueshëm dhe pagesave të drejtpërdrejta të përcaktuara.
2. Sipas këtij ligji, shtetasit gëzojnë këto të drejta:
 - a) të përdorin shërbimet e kujdesit shëndetësor, që janë pjesë e paketës së përfitimeve të detyrueshme ose bazë, që sigurohen nga institucionet dhe ofruesit e shëndetit publik në zbatim të legjislacionit në fuqi;
 - b) të informohen për ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit, në funksion të marrjes së vendimeve lidhur me shëndetin vetjak dhe të familjeve të tyre;
 - c) të informohen nga ofruesit e shërbimeve shëndetësore për veçoritë e shërbimeve shëndetësore, mënyrën e përdorimit të tyre, për të drejtat e tyre, si shtetas dhe pacientë, për kartën e pacientit dhe gabimet mjekësore, si dhe për zbatimin e tyre;
 - ç) të japin pëlqimin për kujdesin shëndetësor që do t'u ofrohet;
 - d) të marrin pjesë aktive, në përputhje me legjislacionin në fuqi, në programimin dhe zbatimin e veprimtarive të kujdesit shëndetësor, veçanërisht, në drejtim të respektimit të të drejtave të pacientit.

KREU III

STRUKTURA DHE ORGANIZIMI I SISTEMIT SHËNDETËSOR

Neni 7

Sistemi shëndetësor i integruar

1. Kujdesi shëndetësor sigurohet nga një sistem i integruar i shërbimeve shëndetësore dhe një rrjet institucionesh publike ose private dhe zbaton sistemin e referimit.
2. Ministria e Shëndetësisë përgatit dhe përditëson, të paktën çdo tri vjet, një plan të rrjetit të integruar të institucioneve të kujdesit shëndetësor publik, për të racionalizuar dhe rritur në maksimum përdorimin e kapacitetit dhe të performancës së çdo spitali dhe për të shmangur mbivendosjen e shërbimeve.
3. Plani i rrjetit të integruar të institucioneve të kujdesit shëndetësor publik përmban llojin dhe numrin e shërbimeve që ato ofrojnë, bazuar në nevojat e popullatës.

Neni 8

Financimi i kujdesit shëndetësor

1. Kujdesi shëndetësor financohet nga:
 - a) Buxheti i Shtetit;
 - b) sigurimet shëndetësore të detyrueshme dhe vullnetare;
 - c) sigurimet shëndetësore private;
 - ç) pagesat e drejtpërdrejta.
2. Sigurimi shëndetësor i detyrueshëm dhe sigurimet shëndetësore private rregullohen me ligje të veçanta.

Neni 9

Kujdesi shëndetësor parësor

1. Kujdesi shëndetësor parësor sigurohet nëpërmjet një rrjeti profesionistësh dhe institucionesh shëndetësore, në bazë të parimeve të kujdesit shëndetësor familjar.

2. Kujdesi shëndetësor parësor organizohet në mënyrë të tillë, që çdo person, që jeton brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të ketë mundësinë të përdorë ofruesit e kujdesit shëndetësor parësor, të drejtën të zgjedhë një kontakt të kujdesit shëndetësor parësor dhe të regjistrohet pranë kontaktit të zgjedhur të ofruesit të kujdesit shëndetësor parësor.

3. Kujdesi shëndetësor parësor sigurohet pa kufizime, që rrjedhin nga sëmundja, mosha, gjinia, gjendja ekonomike ose kategoritë e pacientëve. Kujdesi shëndetësor parësor plotëson nevojat për trajtim mjekësor bazë, kujdes infermieror, parandalim dhe riaftësim, kur këto nuk kërkojnë trajtim dhe teknika ekzaminimi, që ofrojnë nivelet e tjera të kujdesit shëndetësor.

4. Ministri i Shëndetësisë miraton, me urdhër, rregulloret për organizimin dhe funksionimin të kujdesit shëndetësor parësor.

Neni 10

Kujdesi spitalor

1. Kujdesi spitalor u ofrohet shtetasve në nevojë për diagnostikim, ekzaminim, dhe/ose trajtim të përqendruar në spital, që nuk mund të ofrohen prej kujdesit shëndetësor parësor, në përputhje me sistemin e referimit.

2. Organizimi dhe funksionimi i veprimtarive të shërbimeve të kujdesit shëndetësor spitalor, publik ose privat, përcaktohen me ligj të veçantë.

Neni 11

Shërbimi i urgjencës mjekësore

1. Shërbimi i urgjencës mjekësore përfshin kujdes klinik dhe paraspitalor, në situatat kur jeta e një shtetasi është në rrezik.

2. Nevoja për shërbimin e urgjencës mjekësore përfundon me stabilizimin e gjendjes shëndetësore të pacientit ose me pranimin e tij në spital.

3. Ministri i Shëndetësisë miraton, me urdhër, rregulloren për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve të urgjencës mjekësore dhe financimin e tyre.

Neni 12

Shëndeti publik

Organizimi, funksionimi dhe veprimtaria e shërbimit të shëndetit publik rregullohen me ligj të veçantë.

Neni 13

Shëndeti mendor

Rregullat për ofrimin e kujdesit shëndetësor mendor rregullohen me ligj të veçantë.

Neni 14

Shëndeti stomatologjik

1. Shërbimi stomatologjik ofrohet vetëm nga profesionistë të licencuar në fushën e kujdesit stomatologjik.

2. Rregullat e organizimit dhe të funksionimit të shërbimit stomatologjik rregullohen me ligj të veçantë.

Neni 15

Kujdesi për të sëmurët terminalë

1. Kujdesi për të sëmurët terminalë është kujdesi mjekësor dhe infermieror në stadin e fundit të një pacienti, sëmundje e cila, me mundësitë aktuale, është e pashërueshme.

2. Kur një person ka ndërruar jetë, ofrimi i shërbimit duhet të bëhet mbi bazën e normave të deontologjisë mjekësore.

Neni 16

Shërbimi farmaceutik

1. Shërbimi farmaceutik ofrohet vetëm nga profesionistë të licencuar të kësaj fushe.
2. Rregullat e organizimit dhe të funksionimit të shërbimit farmaceutik përcaktohen me ligj të veçantë.

Neni 17

Shërbimi shëndetësor në punë

1. Kujdesi shëndetësor profesional përfshin masat parandaluese dhe të sigurisë, këshillimin e punëdhënësve, të punonjësve dhe përfaqësuesve të tyre, për kërkesat e krijimit dhe të ruajtjes së një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm, në shërbim të punës dhe të përshtatjes së punës me aftësitë e punonjësve, duke marrë parasysh gjendjen e tyre shëndetësore, fizike dhe mendore. Ai përfshin, gjithashtu, edhe identifikimin e vlerësimit e rreziqeve në vendin e punës, mbikëqyrjen e faktorëve në mjedisin e punës dhe të praktikave të punës, që mund të cenojnë shëndetin e punonjësve.
2. Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta koordinojnë punën për minimizimin e aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale në punë.
3. Ministri i Shëndetësisë përcakton, me akte nënligjore, rregullat e organizimit dhe të funksionimit të shërbimit shëndetësor profesional në spital/në punë.

Neni 18

Shërbimi optik

1. Shërbimi optik përbëhet nga tërësia e shërbimeve, që ofrohen nga opticieni dhe laboranti optik, për korrigjimin dhe riaftësimin e shikimit, me anën e zbatimit të metodave të jashtme të korrigjimit, duke përfshirë, në këtë mënyrë, ndërhyrjen kirurgjikale, që i përket specialitetit mjekësor të oftalmologjisë.
2. Rregullat e organizimit dhe të funksionimit të shërbimit optik përcaktohen nga Ministri i Shëndetësisë.

Neni 19

Mjekësia rehabilituese dhe sportive

1. Mjekësia rehabilituese është shkenca që merret me rikthimin e aftësive të humbura ose të paarritura akoma, si shkak i një sëmundjeje ose rrethane përfshirëse dhe ofrohet nga fizioterapisti me diplomë universitare.
2. Fizioterapisti punon në bashkëpunim me një grup profesionistësh me kompetenca të ndryshme, të cilët ndihmojnë në rikthimin e autonomisë në fushën konjitive dhe psikologjike, për të arritur nëpërmjet përdorimit të teknikave me duar apo aparateve elektromjekësore, zvogëlimin e paaftësisë, nëpërmjet rikthimit të shëndetit, përmirësimit të aftësive të mbetura dhe përmirësimin e pjesëmarrjes.
3. Mjekësia e sportit është formë e dhënies së shërbimit të kujdesit shëndetësor për sportistët aktivë, që zbatohet si pjesë e shërbimeve të kujdesit shëndetësor.
4. Ministri i Shëndetësisë përcakton, me akte nënligjore, rregullat e organizimit dhe funksionimit të shërbimit të mjekësisë së sportit.

Neni 20

Mjekësia alternative

1. Mjekësia alternative është tërësia e praktikave shëndetësore parandaluese dhe mjekuese, të tilla si homeopatia, naturopatia, kiropraktika dhe mjekësia bimë, të cilat nuk ndjekin metodat mjekësore të përgjithshme, të pranura dhe mund të mos kenë një shpjegim shkencor për efikasitetin e tyre.
2. Fusha e trajtimeve, kushtet dhe mënyra e përdorimit të metodave jokonvencionale terapeutike përcaktohen me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.
3. Ndalohej reklamimi dhe ushtrimi i metodave të mjekësisë alternative të palicencuara nga Ministria e Shëndetësisë.

KREU IV

STANDARDET E KUJDESIT SHËNDETËSOR

Neni 21

Standardet e përgjithshme për institucionet e kujdesit shëndetësor

1. Ofruesit e shërbimeve shëndetësore duhet që, gjatë ofrimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor, të veprojnë në përputhje me standardet profesionale dhe etike, të përcaktuara nga Ministri i Shëndetësisë dhe urdhrat e profesionistëve.

2. Ministri i Shëndetësisë, me urdhër, miraton normat dhe standardet e shërbimeve të kujdesit shëndetësor.

3. Ministri i Shëndetësisë miraton, me urdhër, rregulloret lidhur me llojet dhe nivelin e shërbimeve të institucioneve të kujdesit shëndetësor.

Neni 22

Cilësia e shërbimit

1. Cilësia dhe siguria e kujdesit shëndetësor në përputhje me standardet është detyrim profesional dhe etik i kujdesit shëndetësor.

2. Të gjitha institucionet e kujdesit shëndetësor krijojnë programet dhe mekanizmat e nevojshëm për zbatimin e strategjisë kombëtare të cilësisë, të hartuar nga Ministria e Shëndetësisë.

3. Qëllimi i menaxhimit të cilësisë është të masë, të vlerësojë dhe të përmirësojë ofrimin e kujdesit të pacientit, si dhe të zhvillojë e të implementojë programe efikase të menaxhimit të sëmundjes, protokolleve klinike dhe udhëzuesve mjekësorë.

Neni 23

Mbikëqyrja e institucioneve të kujdesit shëndetësor

1. Ministria e Shëndetësisë mbikëqyr zbatimin e rregullave dhe të standardeve në institucionet e kujdesit shëndetësor.

2. Institucionet shëndetësore janë të detyruara të pranojnë mbikëqyrjen nga Ministria e Shëndetësisë.

3. Mbikëqyrja e institucioneve shëndetësore përfshin mbikëqyrjen e brendshme dhe mbikëqyrjen e jashtme, inspektimin.

Neni 24

Mbikëqyrja e brendshme

1. Mbikëqyrja e brendshme profesionale organizohet dhe drejtohet nga drejtorët e institucioneve të kujdesit shëndetësor, në zbatim të rregullave të brendshme operative, bazuar në standardet e përcaktuara nga Ministri i Shëndetësisë.

2. Mbikëqyrja e institucionit ka si objekt:

a) zbatimin e ligjit dhe të akteve nënligjore;

b) zbatimin e standardeve profesionale dhe të cilësisë.

3. Të gjithë librat, regjistrat dhe të dhënat e tjera, në formë elektronike ose në letër, duhet të vihen në dispozicion të inspektorit të autorizuar, me kërkesën e tij. Pengimi apo ndalimi i veprimtarive të inspektorit të autorizuar, nga cildo zyrtar apo punonjës i institucionit të kujdesit shëndetësor, përbën shkelje.

Neni 25

Mbikëqyrja e jashtme, inspektimi

1. Inspektimi i jashtëm i aspekteve administrative dhe profesionale të institucioneve të kujdesit shëndetësor kryhet nga Inspektorati Shëndetësor Shtetëror.

2. Detyrat dhe përgjegjësitë e organeve mbikëqyrëse, si dhe mënyra e mbikëqyrjes përcaktohen me ligj të veçantë.

Neni 26

Akreditimi

1. Të gjitha institucionet shëndetësore duhet të akreditohen nga Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit, në mënyrë periodike, për të vlerësuar shkallën e plotësimit nga ana e tyre të standardeve të paracaktuara dhe të publikuara për to nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.

2. Rregullat dhe mënyra e realizimit të procesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit

shëndetësor përcaktohen nga Këshilli i Ministrave.

Neni 27
Licencimi

1. Licencimi dhe rilicencimi është proces i detyrueshëm për personat fizikë ose juridikë, që ofrojnë shërbime shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.
2. Licencimi dhe rilicencimi i institucioneve shëndetësore rregullohet me ligj të veçantë.

KREU V
KUSHTET DHE PROCEDURAT PËR OFRIMIN E KUJDESIT SHËNDETËSOR

Neni 28
Sistemi i referimit

1. Kontakti i shtetasit me ofruesin e shërbimit të kujdesit shëndetësor parësor ose me mjekun e familjes përbën pikën fillestare të procesit të ofrimit të shërbimit të kujdesit shëndetësor dhe zhvillohet mbi bazën e sistemit të referimit/përcjelljes drejt niveleve të tjera të kujdesit shëndetësor.
2. Ministri i Shëndetësisë përcakton mënyrën e funksionimit të sistemit të referimit/përcjelljes së pacientëve.

Neni 29
Vendi ku ofrohet shërbimi shëndetësor

Shërbimet e kujdesit shëndetësor mund të ofrohen në institucione shëndetësore (spitale, klinika, qendra shëndetësore) dhe në vende të përcaktuara e të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

KREU VI
INFORMACIONI SHËNDETËSOR

Neni 30
Sistemi i informacionit shëndetësor

1. Ministria e Shëndetësisë ngre dhe mban një sistem unik të informacionit shëndetësor, në bazë të standardeve europiane të informacionit shëndetësor. Të gjitha institucionet, që mbledhin të dhëna shëndetësore, janë të detyruara t'i ofrojnë Ministrisë së Shëndetësisë akses për këtë informacion, duke ruajtur fshehtësinë.
2. Ofruesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, publik ose privat, janë të detyruar të mbledhin dhe të raportojnë të dhëna, në mënyrë periodike, sipas formatit dhe mënyrës së raportimit, që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Të dhënat e sistemit shëndetësor krijohen nëpërmjet grumbullimit dhe evidentimit të të dhënave në dokumentacionin shëndetësor, që mund të jetë dokumentacion, i cili mbetet në institucion ose në pronësi të pacientit.
4. Profesionistët e shëndetit janë përgjegjës për saktësinë e të dhënave të regjistruara në dokumentacionin dhe evidencën mjekësore, ndërkohë që institucionet e kujdesit shëndetësor janë përgjegjëse për ruajtjen e konfidencialitetit.

KREU VII
PROFESIONISTËT E SHËNDETËSISË

Neni 31
Profesionistët e shëndetësisë

1. Regjistrimi i profesionistëve është një proces i detyrueshëm, i cili kryet nga Ministria e Shëndetësisë.
2. Ministri i Shëndetësisë miraton, me urdhër, rregulloren për procedurat e regjistrimit dhe reregjistrimit të profesionistëve të shëndetësisë.

Neni 32
Urdhrat e profesionistëve

1. Urdhrat e profesionistëve krijohen për të ruajtur rregullat e etikës dhe deontologjisë mjekësore

nga profesionistët e kujdesit shëndetësor.

2. Profesionistët e kujdesit shëndetësor regjistrohen pranë urdhrave profesionistë përkatës dhe janë subjekt i detyrave dhe përfitimeve korresponduese.

3. Funksionimi i urdhrave të profesionistëve rregullohet me ligje të veçanta.

Neni 33

Edukimi i vazhdueshëm profesional

1. Ministria e Shëndetësisë krijon programe të detyrueshme për edukimin e vazhdueshëm profesional.

2. Profesionistët e kujdesit shëndetësor janë të detyruar që t'i nënshtrohen edukimit të vazhdueshëm profesional të përditësuar, për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre profesionale, në mënyrë që të rrisin cilësinë e kujdesit shëndetësor.

3. Punësimi, privilegjet ose kontratat në institucionet shëndetësore përfundojnë, nëse stafi profesionist nuk i nënshtrohet procesit të edukimit të vazhdueshëm, të përcaktuar nga Ministria e Shëndetësisë.

4. Institucionet e kujdesit shëndetësor i nënshtrohen sanksioneve, në rast se ato punësojnë specialistë, të cilët nuk përmbushin kërkesat e parashikuara në këtë nen.

5. Institucionet e kujdesit shëndetësor lehtësojnë edukimin e vazhdueshëm profesional të profesionistëve shëndetësorë.

KREU VIII

KUJDESI SHËNDETËSOR NË GJENDJET E EMERGJENCËS SHËNDETËSORE

Neni 34

Gjendja e emergjencës shëndetësore

1. Gjendja e emergjencës shëndetësore është çdo situatë e papritur që rrezikon jetën, integritetin dhe shëndetin e shtetasve, ose që cenon funksionimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor.

2. Ministri i Shëndetësisë përgatit planet e emergjencës kombëtare shëndetësore me veprimtaritë shoqëruese dhe financimin e jashtëzakonshëm, koordinuar me plane të ngjashme për emergjencat civile.

3. Ministri i Shëndetësisë ngre dhe zhvillon sistemin e gatishmërisë së paralajmërimit të hershëm.

Neni 35

Masat për përballimin e emergjencës shëndetësore

1. Ministri i Shëndetësisë përgatit dhe zotëron një plan të përditësuar të emergjencës shëndetësore, që përmban masat që do të ndërmerren gjatë një situatë të tillë, në bazë të udhëzimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

2. Gjatë gjendjes së emergjencës shëndetësore, të drejtat e qytetarëve, të përkufizuar në këtë ligj dhe rregulloret, respektohen, me kusht që të mos rrezikojnë efektivitetin e masave të ndërmarra dhe mirëqenien e popullsisë.

3. Këshilli i Ministrave siguron financimin e kostos së jashtëzakonshme për veprimtaritë e përfshira në rastet e gjendjes së emergjencës shëndetësore, duke përdorur fondin rezervë të Këshillit të Ministrave, në përputhje me përcaktimet e Planit Kombëtar të Emergjencës Shëndetësore.

4. Të gjitha institucionet e kujdesit shëndetësor, publike ose private, bashkëpunojnë, sipas përcaktimeve të bëra në Planin Kombëtar të Emergjencave Shëndetësore dhe veprojnë në bazë të planeve të tyre të emergjencave shëndetësore, të miratuara në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë.

Neni 36

Ofrimi i shërbimit në rast emergjence civile

Në rast situatë të një emergjence civile, kujdesi shëndetësor ofrohet në zbatim të legjislationit në fuqi për emergjencat civile.

Neni 37

Shërbimi i kujdesit shëndetësor për shtetasit e huaj

1. Shërbimi i kujdesit shëndetësor, që ofrohet në institucionet e kujdesit shëndetësor për shtetasit e huaj, që banojnë në Republikën e Shqipërisë, bëhet në bazë të marrëveshjeve përkatëse ndërkombëtare ose në bazë të parimit të reciprocitetit.

2. Në mungesë të një marrëveshjeje ndërkombëtare apo të kushteve ku zbatohet parimi i

reciprocitetit, shtetasit e huaj përfitojnë shërbimet e kujdesit shëndetësor, në bazë të dispozitave të këtij ligji dhe të ligjit të financimit të kujdesit shëndetësor.

3. Shtetasit e huaj, që kanë nevojë për kujdes shëndetësor, në kushtet e urgjencës mjekësore, marrin kujdes shëndetësor dhe në kushte të barabarta me ato që zbatohen për shtetasit e Republikës së Shqipërisë.

4. Në rast vdekjeje të shtetasit të huaj në një institucion shëndetësor, drejtuesi i këtij institucioni njofton menjëherë zyrtarin përfaqësues të vendit në fjalë.

KREU IX SANKSIONET ADMINISTRATIVE

Neni 38 **Kundërvajtjet administrative**

Ofrimi i kujdesit shëndetësor në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet nga Inspektorati Shtetëror i Shëndetësisë si më poshtë:

a) Mospërmbushja e detyrimeve të parashikuara në nenet 21 e 22, të lidhura me standardet e përgjithshme dhe cilësinë e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë dhe, në rast të përsëritura, me heqje licence.

b) Refuzimi nga ofruesi i shërbimit i procesit të mbikëqyrjes shtetërore, të ushtruar nga institucionet përgjegjëse, sipas neneve 23, 24 e 25 të këtij ligji, me gjobë nga 20 000 deri në 50 000 lekë.

c) Shkelja e neneve 26 e 27 të këtij ligji nga personat fizikë ose juridikë, publikë ose privatë, që ofrojnë kujdes shëndetësor në Republikën e Shqipërisë, me gjobë 500 000 lekë dhe, në rast përsëritjeje, me 5-fishin e gjobës dhe denoncim në organet kompetente.

ç) Mosregjistrimi i profesionistëve të shëndetësisë, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 31, me gjobë nga 5 000 deri në 10 000 lekë.

Neni 39 **Ankimi**

1. Kundër vendimit të Inspektoratit Shtetëror të Shëndetësisë mund të bëhet ankim pranë Ministrit të Shëndetësisë.

2. Shqyrtimi i kundërvajtjeve administrative, ankimi dhe ekzekutimi i vendimeve bëhen sipas ligjit nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, të ndryshuar.

KREU X DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 40 **Aktet nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 26 pika 2.

2. Ngarkohet Ministri i Shëndetësisë që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 9 pika 4, 11 pika 3, 17 pika 3, 18 pika 2, 19 pika 4, 20 pika 2, 21 pikat 2 e 3 dhe 24 pika 1.

Neni 41 **Shfuqizime**

Ligji nr.3766, datë 17.12.1963 “Për kujdesin shëndetësor”, të ndryshuar, si dhe çdo dispozitë tjetër, ligjore apo nënligjore, që bie në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 42 **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6129, datë 8.4.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 110, datë 2.4.2009

**PËR NJË NDRYSHIM DHE NJË SHITESË NË LIGJIN NR.9228,DATË 29.4.2004 “PËR
KONTABILITETIN DHE PASQYRAT FINANCIARE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 4 “Standardet kontabël, që zbatohen për hartimin e pasqyrave financiare”, në fjalinë e parë të pikës 1, fjalët “me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni” zëvendësohen me fjalët “me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikat 1/1, 2 e 3 të këtij neni”.

Neni 2

Në nenin 4, pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Mikrondërmarrjet, sipas përcaktimit të bërë në ligjin nr.8957, datë 17.10.2002 “Për ndërmarrjet e vogla e të mesme”, të ndryshuar, nuk zbatohen, në mënyrë të detyruar, standardet kombëtare të kontabilitetit. Ato e mbajnë kontabilitetin dhe i hartojnë pasqyrat financiare sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.6139, datë 17.4.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 111, datë 2.4.2009

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9831, DATË 12.11.2007 “PËR
DËMSPËRBLIMIN E ISH TË DËNUARVE POLITIKË TË REGJIMIT KOMUNIST”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmspërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 2, pas paragrafit të dytë shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Procedura e shqyrtimit administrativ të kërkesave dhe masa e dëmspërblimit financiar për familjarët e viktimave të ekzekutuara padrejtësisht pa gjyq, për motive politike, gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Në nenin 3, pas shkronjës “ë” shtohet shkronja “f” me këtë përmbajtje:

“f) akti administrativ apo dokumenti zyrtar që provon internimin në kampe me rrethim me tela me gjemba.”.

Neni 3

Në nenin 4, në fund të shkronjës “d”, pas fjalëve “për jetën e shtetasve të tjerë” shtohen fjalët “gjatë periudhës 30.11.1944 deri më 1.10.1991”.

Neni 4

Në nenin 5 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në shkronjën “c”, në referencën për nenin 3 shtohen pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 14, si dhe neni 6 i ligjit nr. 372, datë 12.12.1946 “Mbi fajet penale kontra popullit dhe shtetit”.

2. Në shkronjën “ç”, në fund të fjalisë shtohen fjalët “si dhe në nenin 3 të ligjit nr.1209, datë 10.1.1951 “Mbi mbrojtjen e paqes midis popujve””.

3. Në shkronjën “d” dispozitat ekzistuese të Kodit Penal të vitit 1952 ndryshohen si më poshtë :

Neni 71 “Sabotimi”

Neni 72 “Agjitacioni dhe propaganda kundër pushtetit popullor”

Neni 73 “Nxitja e urrejtjes ose grindjeve midis kombësive, racave ose feve”

Neni 74 “Propaganda e luftës”

Neni 75 “Pjesëmarrja në një organizatë kundër pushtetit popullor”

Neni 82 “Veprimtaria para çlirimit”

Neni 83 “Solidarësia ndërkombëtare”

Nenet 105, 106, 107 e 108 “Krime në lidhje me tatimet dhe detyrimet”

Neni 226 “Moskallëzim i krimit”, paragrafi i parë për moskallëzim të një krimi kundër shtetit, të parashikuar në nenet 64, 69, 70, 71, 72, 74, 75, 82, 83 të këtij Kodi.

Neni 259 “Kalim i paligjshëm i kufijve të shtetit”.

Neni 5

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8

Rrethi i familjarëve sipas këtij ligji

1. Në kuptim të këtij ligji, me familjarë nënkuptohen, pavarësisht nga rregullime të tjera ligjore, paraardhësit, bashkëshortja, pasardhësit, vëllezërit dhe motrat e ish të dënuarit politik, si dhe fëmija/fëmijët e vëllezërve dhe motrave.

2. Familjarët, në shkallë më të parë, sipas Kodit Civil, përjashtojnë familjarët e tjerë.”.

Neni 6

Në paragrafin e parë të nenit 12 fjalët “në mënyrë të barabartë” zëvendësohen me fjalën “proporcionale”.

Neni 7

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:

1. Paragrafi i tretë, i katërt dhe i gjashtë shfuqizohen, ndërsa paragrafi i dytë riformulohet si më poshtë:

“Kur ish i dënuari politik ka vdekur para ose vdes pas depozitimit të kërkesës në Ministrinë e Drejtësisë, familjarët e përcaktuar në nenin 8 të këtij ligji, për çeljen e depozitës bankare, duhet të depozitojnë në Ministrinë e Financave këtë dokumentacion:

- a) certifikatën e vdekjes së ish të dënuarit politik;
- b) dëshminë e trashëgimisë të ish të dënuarit politik;
- c) kopje të vlefshme të dokumentit të identitetit;
- ç) certifikatën e trungut familjar.”.

2. Paragrafi i pestë riformulohet si më poshtë:

“Kur trashëgimtarët, sipas këtij ligji, e kanë deleguar me prokurë/akt njërit prej tyre, veprimet nga

Ministria e Financave bëhen në emër të personit me këtë të drejtë.”.

Neni 8

Në fjalinë e parë të nenit 15, pas fjalëve “në emër të ish të dënuarit politik” shtohen fjalët “apo familjarëve përfitues”.

Neni 9

Në nenin 19 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1 fjalët “Brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji” zëvendësohen me fjalët “Brenda datës 1.7.2009”.

2. Në pikën 2 fjalët “brenda afatit 1-vjeçar” dhe “kur ka kaluar mbi 1 vit nga hyrja në fuqi e këtij ligji” zëvendësohen respektivisht me fjalët “brenda afatit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni” dhe “pas datës 1.7.2009”.

Neni 10

Në nenin 20 bëhen shtesat e mëposhtme:

1. Në shkronjën “c”, pas fjalëve “aktin e internimit” shtohen fjalët “aktin administrativ apo dokumentin zyrtar që provon internimin në kampe me rrethim me tela me gjemba.”.

2. Në paragrafin e fundit shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Në këto raste kërkuesi paraqet dokumentacionin që provon lidhjen familjare me ish të dënuarin politik, si dhe dokumentacionin që provon se cilët nga familjarët përfitues, të parashikuar në nenin 8 të këtij ligji, janë të gjallë.”.

Neni 11

Në paragrafin e dytë të nenit 23, fjalët “në përfundim të afatit 1-vjeçar”, zëvendësohen me fjalët “pas datës 1.7.2009”.

Neni 12

Në nenin 32, fjalia e dytë ndryshohet si më poshtë:

“Këshilli i Ministrave, brenda vitit 2009, miraton afatet dhe skemën e shpërndarjes së fondeve.”.

DISPOZITA KALIMTARE

Neni 13

1. Kërkuesit që kanë paraqitur kërkesë për përfitimin e dëmshpërblimit financiar në Ministrinë e Drejtësisë dhe janë njoftuar me “njoftim negativ”, në përputhje me shkronjat “b” dhe “c” të nenit 24 “Veprimet paraprake” të këtij ligji, kanë të drejtë të riparaqesin kërkesë të re për të rikonfirmuar vullnetin e tyre, si dhe certifikatën e lindjes, të lëshuar jo më vonë se 45 ditë nga dorëzimi i kësaj kërkesë të dytë, të cilat i bashkëlidhen dokumentacionit të paraqitur prej tyre.

2. Pas regjistrimit të dokumentacionit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë fillon procedurën e shqyrtimit administrativ për përfitimin e dëmshpërblimit financiar.

3. Struktura përgjegjëse në Ministrinë e Drejtësisë rivlerëson edhe një herë kërkesat e paraqitura për dëmshpërblim financiar për ish të dënuarit politikë, të cilat preken nga ndryshimi i nenit 4 shkronja “d”.

Neni 14

Ministria e Drejtësisë fillon procedurën e shqyrtimit administrativ për të gjitha kërkesat për përfitimin e dëmshpërblimit financiar, të paraqitura pas datës 19.12.2008.

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 15

Aktet nënligjore

Në përputhje me parimet e rivendosjes së të drejtave, të barazisë para ligjit dhe të procesit të rregullt ligjor, ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktin nënligjor në bazë të nenit 2 të ligjit.

Neni 16
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6140, datë 17.4.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Ndreqje gabimi

Në Fletoren Zyrtare nr.39, prill 2009, në faqen 2093, në nenin 93 pika 5 korrigohej si vijon:
“5. Zëvendësudrejtori i IEPV, emërohet, lirohet dhe shkarkohet nga Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve me propozim të drejtorit të IEPV-së.”

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 23.4.2009
Doli nga shtypi më 23.4.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 48 lekë